

VLERËSIMI I PARË I KUFIZUAR I INDIKIMIT MBI MJEDISIN JETËSORË DHE SOCIAL

Projekt "Kategoria B +"

Ndërtimi i kopshtit të ri në
Komunën e Likovës
(venbanimi Matejç)



Robert Kneschke - Fotolia.com

Mars 2021

I përgatitur nga:

MSc. Slavjanka Pejçinovska-Andonova, Inxhinieri e mjedisit jetësorë

Specialiste e mbrojtjes të mjedisit jetësorë dhe social

PËRMBAJTJA

HYRJA.....	1
1. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT	2
2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	3
2.1 Aktivitetet projektuese.....	8
3. TË DHËNAT THEMELORE	9
3.1 Pranuesit e ndjeshëm.....	12
4. NDIKIMET DHE RREZIQET POTENCIALE MBI MJEDISIN JETËSORË DHE VLERËSIMI I NDIKIMIT DHE VLERËSIMI I RREZIKUT.....	13
5. ZBATIMI I PMMJS.....	16
6. ZBULIMI PËR PUBLIKUN	17
7. PLANI PËR MJEDISIN JETËSORË DHE ZBUTJEN SOCIALE	20
8. PLANI I MONITORIMIT TË MJEDISIT JETËSORË DHE SOCIAL	26
Aneksi I Harta e zonave të ndjeshme në rrethinën e gjërë dhe të ngushtë të zonën të projektit në Komunën e Likovës.....	30
Aneksi II Konsideratat për KOVID-19 në projektet e ndërtimit/ punët ndërtimore.....	31

TË DHËNAT

Figura 1 Lokacioni i kopshtit të ri në raport me fshatin Matejç dhe Komunën e Likovës.....	2
Figura 2 Lokacioni i projektit dhe rrethina e tij (foto të bërë në datë 4.2.2021).....	3
Figura 3 Plani për katin përdhësë	6
Figura 4 Plani për katin e parë	7
Figura 5 Harta Seizmologjike e RMV.....	9
Figura 6 Peizazhi i MN “Orashac” dhe zona e propozuar për mbrojtje “Gryka e Bislimit”	11
Figura 7 Manastiri i Zhegligovës (së fundi njihet si Manastiri i Matejçës).....	12
Figura 8 Lokacioni i ZRB “Mali i Zi i Shkupit” në lidhje me lokacionin e projektit.....	30
Figura 9 Lokacioni i ZRZ “Lumi Pčinja, Lumi Petroshtica, Lumi Kriva Reka” në lidhje me lokacionin e projektit	30
Figura 10 Lokacioni i zonës Emerald “Pchinja-German” në lidhje me lokacionin e projektit.....	30
Figura 11 Lokacioni i Monumentit të natyrës “Orashac” lidhur me lokacionin e projektit	30

TABELAT

Tabela 1 Aktivitetet e planifikuara në fazën e ndërtimit	8
Tabela 2 Ndikimet dhe rreziqet potenciale	13
Tabela 3 Konsideratat për KOVID-19 në projektet e ndërtimit / punët ndërtuese të rekomanduara nga BB	32

Shkurtesat

PK	Parcela Kadastrale
VNMJS	Vlerësimi i ndikimit në mjedisin jetësorë dhe social
KMMJS	Korniza e menaxhimit të mjedisit jetësorë dhe social
PMMJS	Plani i menaxhimit të mjedisit jetësorë dhe social
SMJS	Standardi i mjedisit jetësorë dhe social
VNMJ	Vlerësimi i ndikimit në mjedisin jetësorë
MZ	Mbrojtja nga zjarri
ZRZ	Zona e rëndësishme për zogjtë
ZRB	Zona e rëndësishme për bimët
SHMSSH	Shoqata maqedonase e sigurisë dhe shëndetit në punë
MK	Mercalli
MMJPH	Ministria e mjedisit jetësorë dhe planifikimit hapësinorë
MPPS	Ministria e punës dhe politikës sociale
PN	Parku nacional
SSH	Siguria dhe shëndeti në punë
GZ	Gazeta zyrtare
PPM	Pajisja personale mbrojtëse
NJRP	Njësia për realizimin e projektit
NP	Ndërmarrje publike
RM	Republika e Maqedonisë
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
PZSS	Plani për zbatimin e standardeve sociale
BB	Banka Botërore

HYRJE

Situata e përgjithshme në Republikën e Maqedonisë e Veriut është se nuk ka objekte të mjaftueshme sociale për kujdesin për fëmijët e moshës parashkollore. Në Komunën e Llojanës, sipas të dhënave nga Enti statistikor në RMV në vitin 2018, ka 2200 fëmijë të moshës nga 0 deri në 6 vjet. Mbulimi i fëmijëve në institucionet parashkollore është 1%, ashtuqë me qëllim që të përmbushen nevojat e popullsisë, Komuna e Likovës planifikon të ndërtojë një kopsht të ri në vendbanimin Matejç.

Projekti për ndërtimin e kopshtit në Komunën e Likovës me karakteristikat e tij i takon Aneksit të Dekretit për veprimet dhe aktivitetet për të cilat është i detyrueshëm Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësorë. Për këto aktivitete, është kompetent Kryetari i komunës (Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë Nr. 32/12) apo Kryetari i Qytetit të Shkupit, Kapitulli X – Projektet infrastrukturore, pika 5, Objektet për mbrojtje sociale

Kompania konsulente "Enviro resources" nga Shkupi ka përgatitur raportin e VNMJ për këtë projekt në Shtator të vitit 2020. Kryetari i Komunës të Likovës ka lëshuar Lejen me Numrin e lejes UP1-11/4-27/2021 nga data 27.01.2021 dhe një kopje të tij bashkarisht me Vendimin për leje është dërguar në Ministrinë e punës dhe politikës sociale.

Realizimi i kërkesave të Bankës Botërore, është përgatitur një Kornizë të menaxhimit të mjedisit jetësorë dhe social (KMMJS) si pjesë e projektit për "Përmirësimin e Shërbimeve Sociale" të MPPS të RMV të përgatitur në Maj të vitit 2018 nga ekipi konsulent i Specialistit të mbrojtjes të mjedisit jetësorë dhe social. KMMJS është zgjedhur si mjeti më i përshtatshëm për të kryer një analizë të thellë të aspekteve të mjedisit jetësorë dhe social. KMMJS është përgatitur me qëllim që të sigurojë dhe projekti i propozuar është realizuar në pajtim me Standardet e Bankës Botërore për aspektet e mjedisit jetësorë dhe social, politikat për mbrojtje dhe legjislacionin për mjedisin jetësorë lokal që duhet të përdoret si mjet praktik gjatë periudhës të përdorur për dizajnim, realizim dhe monitorim të aktiviteteve të Projektit.

Kopshti i ri do të akomodojë 102 fëmijë, të moshës 0 deri në 6 vjet. Objekti do të jetë me dy kate (përdhesa dhe kati i parë).

Duke marrë parasysh natyrën, madhësinë, lokacionin si dhe karakteristikat ndikimeve të mundshme potenciale nga ndërtimi i kopshteve në vendbanimin Matejç (Komuna e Likovës) projekti është klasifikuar në kategorinë B+/projekt me rrezik të konsideruar dhe nevojitet që të përgatisë një **Plani i parë i kufizuar i menaxhimit dhe vlerësimit të mjedisit jetësorë dhe ndikimit social.**

1. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT

Komuna e Likovës ndodhet në pjesën veriore të Maqedonisë së Veriut. Komuna kufizohet me Republikën e Serbisë në veri, Komunën e Çußer Sandevës në perëndim, Qytetin e Shkupit në jugperëndim, Komunën e Haraçinës në jug dhe Komiunën e Kumanovës në lindje. Sipas regjistrimit të vitit 2002, Komuna e Likovës ka 27,058 banorë.

Kopshti i ri do të ndërtohet në vendbanimin Matejç në PK 3200, PK 3201/1, PK 3201/2, PK 3201/3, PK 3202/1, PK 3202/2, PK 3202/3 dhe PK 3202/4. Matejç ndodhet në 13 km në perëndim të Kumanovës dhe 4 km në jug të fshatit Likovë, aty ku është edhe objekti i komunës





Figura 1 Lokacioni i kopshtit të ri në raport me fshatin Matejç dhe Komunën e Likovës

Në afërsi të lokacionit të planifikuar, ndodhet objekti për strehim individual, si dhe një ambulancë, e lokalizuar në perëndim të lokacionit të projektit dhe një qendër kulture, që ndodhet në lindje të lokacionit të projektit, në rethinën më të gjërë, Xhamia e Matejçes ndodhet në veri të kopshtit, ndërsa departamenti i policisë të Matejçes ndodhet në lindje të lokacionit të projektit.



Figura 2 Lokacioni i projektit dhe rethina e tij (foto e bërë në 4.2.2021)

Në rethinën e projektit ka një shtëpi, një ambulancë dhe një qendër e kulturës. Kopshti i ri do të ndërtohet në tokë me pronësi shtetërore dhe do të lidhet në rrjetin e kanalizimit të projektit përmes pusetave ekzistuese në lokacionin e projektit dhe infrastrukturën ekzistuese

2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Sipërfaqja e parcelës është 1.704.89 m², kurse parcela e ndërtimit në të cilën do të ndërtohet kopshti është me sipërfaqe prej 560 m², kurse sipërfaqja e përgjithshme e kopshtit do të përbëhet nga kati përdhësë dhe kati i parë me 1.030 m².

Zgjidhja funksionale e objektit është bërë në pajtim me Programin e projektit, që përfshin kapacitet prej 102 fëmijësh. Kopshti do të ketë:

-

- Dy grupe (nga 10-12 fëmijë) për kujdes të fëmijëve në një grup heterogjen ndërmjet moshave prej 6 mujash dhe 2 vietesh (çerdhe);
- 1 grup (nga 12-15 fëmijë) për kujdes për fëmijë në grup homogjen në moshën prej 2 deri në 3 vjet (kopsht),
- 1 grup (nga 15-18 fëmijë) për kujdes për fëmijë në grup homogjen në moshën prej 3 deri në 4 vjet (kopsht),
- 1 grup (nga 18-20 fëmijë) për kujdes për fëmijë në grup homogjen në moshën prej 4 deri në 5 vjet (kopsht),
- 1 grup (nga 20-25 fëmijë) për kujdes për fëmijë në grup homogjen në moshën prej 4 deri në 6 vjet (kopsht).

Pjesa më e ulët në objekt (kati përdhesë) do të ketë hyrje të ndryshme: në anën lindore do të jetë hyrja për prindërit dhe fëmijët e kopshtit, në anën e jugut do të jetë hyrja për çerdhet dhe në anën e veriut do të jetë hyrja administrative. Në katin e njëjtë do të jetë çerdhja, pjesa e dhomave administrative dhe pajisjet teknike si kuzhina (me kapacitet për 100-200 ushqime), dhoma mekanike dhe depo dhe dhoma për energjinë elektrike. Në katin përdhesë përballë dhomës të çerdhes është planifikuar të ketë fusha të hapura për lojëra të lidhura me oborrin fushës të lojërave.

Në katin e parë do të jetë dhoma për zbavitje e orientuar në anën veriore, ndërsa dhomat administrative do të orientohen në anën lindore. Dhomat për zbavitje do të kenë fushë të hapur për lojëra (të mbuluar dhe të rrethuar) të lidhur me fushën e jashtme të lojërave.

Një Elaborat për efikasitetin energjetik është përgatitur gjatë hartimit të Dizajnit kryesor për projektin dhe rrjedhimisht mund të shihet se në pajtim me konsumin e energjisë, do i takojnë klasës "C" të efikasitetit energjetik. Konsumi vjetor i energjisë për m^2 është $96,5 \text{ kWh} / (m^2a)$, që është pak më mirë se kërkesat minimale të theksuara në Rregullore për performancë energjetike të objektit prej $100 \text{ kWh} / (m^2a)$ – Rregullorja për karakteristikat e energjisë të objektit (Gazeta zyrtare e RM nr. 94 (2013), nr.7 (2015), nr.176 (2015).

Për ngrohjen e kopshtit, është planifikuar që të instalohet një bojler me ujë të nxehtë që funksionon me biomasë (peleta) me fuqi prej 90kW të lidhur me shtesë prej 800 l dhe 80/60 °C me një pompë qarkullimi. Karakteristika kryesore e bojlerit është se ata janë shumë efikas dhe ekonomik, me një shkallë të lartë të shfrytëzimit min 92% dhe kursimet e larta të energjisë (peletave), pa humbje të panevojshme të energjisë. Sasia e hirit e formuar nga djegja e peletave është vetëm 0.8-1% minimum (8-10 kg hi per 1 ton peleta). Për të ngrohur ujin për qëllimet sanitare, janë instaluar tre kolektorë diellorë me 82% efikasitet të thithjes

Njësitë e kondicionimit të ajrit (me njësi të brendshme dhe të jashtme) janë vendosur për freskimin e hapësirave. Kondicionerët inverter të ajrit janë vendosur kryesisht për freksimin e hapësirave, por gjithashtu përdoren për ngrohjen e përkohshme kur nuk është funksional sistemi i ngrohjes, dhe nevojitet ngrohje.

Sistemet e pavarura të ventilimit duhet të instalohen për ventilimin (thithës) të instalimeve sanitare, veshjeve dhe kuzhinës

Objekti do të pajiset me veglat për mbrojtjen nga zjarri dhe rrjet hidratues për qëllimin e njëjtë. Mbuluese konstrukti që janë rezistente ndaj zjarrit, dhe gjithashtu do të vendosen dyert që janë rezistente ndaj zjarrit. Në rast të zjarrit, do të aktivizohet zbulimi automatik dhe sistemi i alarmit ndaj zjarrit. Njësi më e afërt e zjarrëfikësve është 14,6 km larg (apo 21 min).

Objekti do të lidhet me rrjetin e furnizimit me ujë të rrugës ekzistuese dhe për kullimin e ujërva të zeza dhe fekale nga objekti është projektuar që të lidhet me rrjetin e kanalizimeve të qytetit.

Lidhja me sistemin e furnizimit me ujë është nga rrjeti i furnizimit me ujë nga rruga ekzistuese. Instalimi i jashtëm është bërë me gypat PE të ujit. Kopshti është lidhur me rrjetin e furnizimit me ujë me një bosht të njehsorit të ujit me një gyp me diametër prej 110 mm diametër dhe një gyp të pusëtës me diametër prej 90 mm.

Dimensioni i prizës nga rrjeti i furnizimit me ujë të asaj rruge është realizuar në pajtim me sasinë e kërkuar të ujit për fikjen e zjarrit, respektivisht operimi simultan i 2 hidrantëve 5 l/s.

Kullimi i ujërave fekale do të realizohet në mënyrë konstruktive me tetë puseta me diametër prej 1000 mm.

Gjatë hulumtimit në terren, niveli i ujërave sipërfaqësore nuk ishte regjistruar në thellësinë e hulumtuar.

Për ndriçimin e përgjithshëm në mjedise është planifikuar instalimi i llampave LED, fluoreshentë dhe CFL. Në hyrje, ballkone dhe banjo do të vendosen llampa fluoreshente që janë rezistente kundër ujit dhe llampa fluoreshente kompakte do të instalohen në dhomën e personave përgjegjës për kujdesje, në kuzhinë që është në katin përdhesë, dhe në dhomën e makinave, do të përdoren llampa fluoreshente që janë rezistente ndaj ujit për temperaturë të rritur.

Planet grafike të kateve janë prezantuar në fotot e mëposhtme.




Figura 3 Plani për katin përdhësë




Figura 3 Plani për katin e parë

2.1 Aktivitetet projektuese

Aktivitetet projektuese mund të ndahen në dy faza: përgatitëse (shënimi gjeodezik i lokacionit të projektuar dhe përgatitja e terrenit për ndërtimin e objektit) dhe ndërtimi i kopshtit dhe aktivitetet që lidhen me ndërtimin e kopshtit.

Aktivitetet kryesore të projektit do të realizohen gjatë ndërtimit të kopshtit në vendbanimin Matejç, Komuna e Likovës, që potencialisht mund të ketë ndikim në mjedis, janë dhënë në Table 1.

Është me rëndësi të përmendet se përdorimi i materialeve me përmbajtje të azbestit është e ndaluar në ndërtimin e kopshtit të ri.

Aktivitet projektuese
I Puna përgatitëse: Shënimi gjeodezik i lokacionit të projektit dhe përgatitja e terrenit për ndërtimin e objektit dhe pastrimi nga vegjetacioni i ulët, degët apo mbetjet (sipërfaqe 200 m²); II Aktivitetet që lidhen me ndërtimin e kopshteve - Vendorsja e gardhit mbrojtës në lokacionin e ndërtimit dhe sinjalizimi për të siguruar qarkullimin e sigurtë në rrugën qasëse; - Shkatërrimi i murit ekzistues në lokacionin me mur të betonit të armuar me trashësi prej 20 cm me lartësi të ndryshme dhe gardh mbrojtës, me ngarkim dhe shkarkim me dorë të materialit nga kamioni dhe transportii në distancë prej deri në 12 km; - Punimet në tokë: Gërmime të kombinuara mekanike (85%) dhe me dorë (15%) (765 m³), heqja e shtresës të tokës dhe instalimi i gjeotesktilëve; - Punimet e betonit: ndërtimi i mureve MB30, shtyllave, mureve të zhavorrit, themeleve dhe shkallëve; - Prokurimi (furnizimi), transportimi, drejtimi, prerja, lakimi dhe montimi i shufrave të çelikut sipas llogaritjes statike, detajet strukturore, dhe planet e përforcimit RA 400 / 500-2, MAR 500/600; - Ndërtimi i mureve ndarëse dhe fasadës me trashësi d=20cm nga blloqet e qeramikës; suvatimi i mureve të brendshme me trashësi prej 15 or 10 cm; - Ndërtimi i konstruksionit të kulmit me shtresë mbrojtëse rezistente ndaj zjarrit me shkallë të mbrojtjes në pajtim me Elaboratin për Mbrojtje nga zjarri, punime të metalit dhe çelësit; - Punët e izolimit, furinzimit dhe instalimi i materialeve izoluese; - Punët e fasadës, vendorsja e fasadës me izolim termik në pajtim me Elaboratin për efikasitet energjetik; - Furnizimi dhe instalimi i dymëve të zakonshme FB si dhe dritareve me efikasitet energjetik; - Instalimi i ujit dhe kanalizimit, transporti dhe vendorsja e gypave dhe elementeve tjera që janë pjesë e rrjetit të ujit dhe kanalizimit në ndërtimin dhe lidhjen e jashtme me rrjetin e kanalizimit dhe furnizimit me ujë të rrugës ekzistuese; - Punët e instalimit elektrik: instalimi i instalimeve të tensionit të ulët (instalimet e alarmit (sirena e alarmit) dhe zbulimi automatik dhe sistemet e alarmit kundër zjarrit, instalimi i dritave për situatat urgjente (drita paniku), intercom, telefoni dhe instalimi i llambave; - Punët termomekanike; instalimi i bojlerit me pelet, instalimi i sistemit të ventilimit në banjo; - Peizazhi urban reth kopshtit duke vendosur pllaka shtruese dhe bar.

3. TË DHËNAT THEMELORE

• Karakteristikat demografike

Komuna mbulon një zonë prej 267.82 km² dhe një dendësi të popullsisë prej 101.03 në një km². Popullsia është 27.058 banorë (2002), shumica e të cilëve janë shqiptarë.

Sipas të dhënave nga Enti për statistika i RMV, në komunë në vitin 2018 ka pasur 2.200 fëmijë të moshës 0-6 vjet. Sipas të dhënave nga komuna, mbulimi i fëmijëve në institucioneve parashkollore është 1%.

• Karakteristikat klimatike

Komuna e Likovës është në ndikim të fortë të veriut në form të erërave të ftohta, sidomos gjatë dimrit. Këto erëra ulin temperaturën në komunë në perudhën dimërore. Muaji më i ftohtë i vitit është Janari, me një temperaturë mesatare prej 0,4 °C dhe temperatura të ulëta prej -24 °C. Korriku është muaji më i nxehtë i vitit me një temperaturë mesatare prej 22,3 °C, ndërsa temperatura më e lartë është 40 °C.

Në nivel vjetor, sasia e ujit nga shiu në rajon është 550 mm, me sasinë më të lartë të rreshjeve që ndodh në pranverë dhe vjeshtë, sidomon në muajin maj (72,1 mm). Nga ana tjetër, vera është e thatë dhe ka rreshjet më të ulëta me muajin gusht që është muaji më i thatë (30,2 mm).

• Seizmologjia

Territori i Komunës të Likovës, ku realizohet projekti, i takon zonat që i nënshtrohen tërmete të shpeshta dhe të fuqishme, të shkaktuara nga pikat e nxehta lokale dhe të largëta të epiqendrës. Në këtë zonë, goditjet janë të mundshme me madhësi prej VIII° në shkallë MK.




Figura 4 Harta Seizmologjike e RMV

• Ujë

Trupi më i afërt i ujit sipërfaqësor, që ndodhet 200m afër lokacionit të projektit, është lumi Mateicka. Ky marrës ujit është dega e djathtë e Lumit të Likovës.

Liqeni i Likovës dhe Glazhnja është afërsisht 8 km në veri të Matejçës. Liqeni i Likovës ka kapacitet prej 2.2500.000 m³ ujë dhe një zonë prej 0,40 km², kurse liqeni i Glazhnja ka kapacitet prej 22.000.000 m³ dhe një zonë prej 1 km². Këto liqene ofrojnë ujë të pastër për pije për Komunën e Likovës, si dhe për Kumanovën.

• Cilësia e ajrit

Stacionet më të afërta të monitorimit automatik të cilësisë të ajrit ndodhen në qytetin e Kumanovës, afërsisht 10km në lindje nga lokacioni i projektit. Qarkullimi lokal, ngrohja e objekteve familjare dhe komerciale gjatë periudhës të dimrit janë burimet kryesore të ndotjes të ajrit në komunë.

Janë duke u matur gjashtë parametra me këto stacione për matje automatike të cilësisë të ajrit: SO₂, PM10, PM2,5, CO, O₃ dhe NO₂.

• Mbetjet

Përsoni juridik përgjegjës për transportimin dhe largimin përfundimtar të mbetjeve në Komunën e Likovës është NPK "Pisha". Aktualisht, mbetjet komunale dhe të ndër-komunale në Komunën e Likovës depozitohen në deponinë zyrtare komunale afër vendbanimit të Nikushtak (afër rrugës nga vendbanimi Nikushtak në vendbanimin Haraçinë). Deponia komunale është organizuar në pajtim me Vendimin e Këshillit Komunal dhe të miratuar nga MMJPH. Komuna e Likovës do të jetë pjesë e qasjes të menaxhimit rajonal të mbetjeve për komunat në rajonet planore Lindore dhe Juglindore (të cilave u takon kjo komunë). Ndërtimi i objektit rajonal të mbetjeve do të jetë në pajtim me standardet e BE-së dhe këto deponi aktive komunale do të mbyllen apo disa do të përmirësohen, duke u bërë stacione të transferimit. Deponia në Nikushtak është e rradhitur si deponi me rrezik të ulët mjedisorë ndërmjet të gjithë 54 deponive komunale që funksionojnë aktualisht në vend. Menaxhimi i përgjithshëm i mbetjeve është organizuar aktualisht (psh mbulimi i mbetjeve me material inert, kompaktimi i rregulltë i mbetjeve me ekskavator).

Si pjesë e realizimit të projektit dhe ndërtimit të kopshteve, pritet se do të krijohen mbetjet ndërtimore, dhe duhet të zgjidhen dhe depozitohen në mënyrë të përshtatshme.

• Toka dhe gjeologjia

Komuna e Likovës karakterizohet me përbërje të ndryshme dhe struktura shumë komplekse tektonike. Ka lloje të ndryshme të sedimenteve, gur metamorfik dhe magmatik që janë nga periudha Paleozoike dhe Mesozoike.

Mermeri në këtë rajon është gjetur në shumë zona dhe në forma të ndryshme, shumica prej tij është gjetur afër Llojanit, Nikushtakut dhe lokacionet tjera. Ata i takojnë një grupi të shkëmbinjve nga seria e Velesit në formë të pllakave të lëmuara me masë të madhe.

Komuna e Likovës është kryesisht kodrinore – ultësinore, përveç për pjesën e Karadakut në Malin e Zit ë Shkupit, dhe karakterizohet me disa male më të vogla (Vuksan, Smilavica, Osterc), shumë prej tyre afër fshatit Matejç.

• Shumëllojshmëria biologjike (Biodiversiteti)

Asnjë specie e rrezikuar, e rëndësishme apo endemike e florës dhe faunës nuk është regjistruar afër lokacionit të projektit, që është e rëndësishme për lokacionin e projektit, që ndodhet rreth 17.3 km në juglindje nga lokacioni i projektit (Figura 10).

MN "Orashac" ndodhet në luginën e lumit Pcinjë, rreth 0,5 km në juglindje nga fshati Orasac, dhe mbulon një zonë prej 3 ha. Ky peizazh është pjesë karakteristike e krahinës Detare Mesdhetare nga Jura e sipërme, në territorin e Maqedonisë së Veriut, e rëndësishme për rindërtimin e kushteve paleo-ekologjike në zhvillimin gjeo-sinklinal të asaj periudhe.

Gryka e Bislimit (zonë e propozuar për mbrojtje) është një grykë e thellë në lumin Pcinja, rreth 15.3 km në juglindje nga lokacioni i projektit. Gryka është 6.5 km e gjatë dhe është prerë në shkëmbinj të shumë gurëve gëlqerorë. Për shkak të ngurtësisë të shkëmbinjve që pret, gryka në disa vende duket si një kanion, me shumë shpella në anët shkëmbore. Gryka e Bislimit njihet për vendet e saj të folëzimit për disa lloje të zogjve grabitqarë dhe faunën e pasur të lakuriqëve. Një pjesë e peizazhit nga MN "Orashac" dhe zona e propozuar për mbrojtje "Gryka e Bislimit" janë të prezantuara në Figura 5.



Peizazhi i MN "Orashac"

Burimi: <https://doma.edu.mk/ekosistem/308-orashac-paleontoloshkoto-bogatstvo-na-kumanovo>



Peizazhi nga zona e propozuar për mbrojtje "Gryka e Bislimit"

Burimi: <http://www.zmurh.hr/2019/04/15/bislimska-klisura/>

Figura 5 Peizazhi i MN "Orashac" dhe zona e propozuar për mbrojtje "Gryka e Bislimit"

• Trashëgimia kulturore

Manastiri i Zhegligovës (së fundi njihet is Manastiri i Matejçës) - Manastiri ortodoks maqedonas në zonën e fshatit të Likovës Matejç, në zonën e Zhegligovës, sipas të cilës njihet tradicionalisht. Ndodhet në një lartësi prej 1.005 metrash, në shpatet juglindore të Malit Mali i Zi i Shkupit, në anën e Kumanovës.



Figura 6 Manastiri i Zhegligovës (së fundi njihet si Manastiri i Matejçës)

3.1 Pranuesit e ndjeshëm

Ndërtimi i kopshtit të ri do të bëhet në vendbanimin urban, në vendbanimin e Matejçës në Komunën e Likovës.

Pranuesi kryesor i ndjeshëm në mjedisin jetësorë do të jenë banorët që jetojnë në objektet individuale të banimit, si dhe njerëzit që punojnë në qendrën e kulturës në afërsi dhe popullsia që punon apo viziton një ambulancë që është në afërsi. Për shkak të kësaj, do të thotë se ndaj tyre duhet të zbatohen masat kryesore.

4. NDIKIMET DHE RREZIQET POTENCIALE MBI MJEDISIN JETËSORË DHE VLERËSIMI I NDIKIMIT DHE VLERËSIMI I RREZIKUT

Zbatimi i aktiviteteve projektuese do të kryhet në dy faza: faza përgatitore (shënimi gjeodezik i lokacionit të ndërtesës dhe përgatitja e terrenit për ndërtimin e objektit) dhe aktivitetet që lidhen me ndërtimin e kopshtit. Ndikimi dhe rreziqet potenciale nga realizimi i aktiviteteve projektuese ndahet në tre faza: faza përgatitëse, ndërtimi dhe faza operacionale. Ky klasifikim është prezantuar në Tabelën 2.

Faza	Aspektet e mjedisit jetësorë	Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut në mjedisin jetësorë
Faza përgatitore	Shëndeti dhe siguria në punë dhe popullsia (sidomos banorët në mjedisin jetësorë më të afërt)	Intensiteti lokal, optimal, dhe i madh
Faza e ndërtimit	Shëndeti dhe siguria në punë dhe popullsia (sidomos banorët në mjedisin jetësorë më të afërta)	Intensiteti lokal, optimal dhe i madh
	Cilësia e ajrit	Intensiteti rajonal, afat-shkurtër, i mesëm
	Zhurma	Intensiteti lokal, afatshkurtër, i mesëm
	Llojet e ndryshme të mbetjeve	Intensiteti lokal, optimal dhe i mesëm
	Ndikimet mbi cilësinë e ujit	Intensiteti lokal, afatshkurtër, i mesëm
	Ndikimet mbi shumëllojshmërinë biologjike	Asnjë
	Ndikimet mbi trashëgiminë kulturore	Asnjë
Faza e operimit	Llojet e ndryshme të mbetjeve	Intensiteti lokal, afatgjatë, i madh
	Shëndeti dhe siguria në punë dhe popullsia (sidomos banorët në mjedisin jetësorë më të afërta)	Intensiteti lokal, afatgjatë, i madh

Kontraktuesi duhet të marrë parasysh llogarinë dhe të përmbush masat e parashikuara në Planin e detajuar zbutës të mjedisit jetësorë dhe Planin për monitorimin e zbatimit të masave zbutëse (të paraqitura në nën-kapitujt e ardhshëm). Mbikëqyrësi do të kryejë dhe monitorojë zbatimin e masave të propozuara për mbrojtjen e mjedisit jetësorë. Komunikimi i mirë ndërmjet: Kontraktuesit, Mbikëqyrësit, Inspektorit të mjedisit jetësor, Inspektorit komunal dhe personat tjerë relevant nga Komuna e Likovës (Konsulenti, inxhinieri, Kryetari i komunës) është thelbësorë për realizimin e mirë dhe në kohë të projektit.

✦ Ndikimet potenciale në shëndetin dhe sigurinë në punë dhe popullsia (sidomos qytetarët në mjedisin jetësorë më të afërta)

Kontraktori duhet të përgatisë **Planin për siguri dhe shëndet në punë (Apo procedurat për menaxhim të punës)** ku masat e parcaktuara në kuadër të legjislacionit nacional të SHS (në pajtim me rregullativën e BE-së dhe Organizatën Ndërkombëtare të Punës) duhet të përdoren si udhëzim. Udhëzimet e GBB për shëndetin dhe sigurinë në mjedisin jetësorë, në veçanti Udhëzimet për ndërtimin dhe çaktivizimin:

(<https://www.ifc.org/wps/wcm/connect/7d708218-2a9e-4fcc-879d-9d5051746e7d/4%2BConstruction%2Band%2BDecommissioning.pdf?MOD=AJPERES&CVID=Is62NKq>)

Ofron burim të mirë për mjedisin jetësorë, por gjithashtu edhe masat parandaluese shëndetësore dhe të sigurisë. Këto mund të përshtaten në lokacion – rethanat specifike.

Plani kërkon që punëtorët në lokacionin e ndërtimit të informohen, dhe projekt masat duhet të zbatohen në mënyrë të rregulltë. Para fillimit të ndërtimit, është e nevojshme që të informohet popullsia lokale (përmes faqes zyrtare të internetit të Komunës të Likovës (<https://komunaelikoves.gov.mk/mk/>) dhe këshilli informues i komunës) për llojin e aktiviteteve projektuese. Plani për menaxhimin e qarkullimit duhet të ketë rrugë alternative të qarkullimit, para fillimit të aktiviteteve ndërtuese. Duhet të ndërtohen gardhe, të vendosen ngjitëse dhe shënime paralajmëruese me qëllim të rritjes të sigurisë të njëzëve që kalojnë në lokacionin e ndërtimit. Vëmendje e veçantë duhet të jepet për instalimet e ujërave të zeza dhe energjisë elektrike, që të mos lënë puseta të hapura dhe kablo të pasigurta të energjisë elektrike.

PPM duhet të ketë për punëtorët. Ata gjithashtu duhet të informohen për Mekanizmin për Rishikimin e Ankesave, si dhe të dretjën për të organizuar organizatat e punëtorëve, nga punëdhënësit e tyre, Kontraktuesi/Nën-kontraktuesi. Të gjithë punëtorët e angazhuar duhet të kenë rregulluar statusin e plotë të punësimit gjatë caktimit të tyre në këtë projekt, dhe siguri i tyre i shëndetit dhe pensionit duhet të mbulohet në tërësi për periudhën e angazhuar nga punëdhënësi i tyre. Formularët e ankesave mund të vendosen në kontejnerët e lëvizshëm për punëtorët.

Duke marrë në konsideratë situatën aktuale me KOVID 19, përveç masave për siguri dhe mbrojtje në punë, plani gjithashtu përfshin masa për parandalimin e KOVID-19. Masat për parandalim nga KOVID-19 përmbajnë rekomandime nga Banka Botërore/OBSH, si dhe rekomandime nga Shoqata Maqedonase për siguri dhe shëndet në punë në formë të Udhëzimit që Kontraktuesi i punëve ndërtimore duhet të zbatojë. Kontraktuesi duhet të ndjek/përditësojë dhe zbatojë masat që janë aktualisht në fuqi dhe të miratuara nga Qeveria e të cilat janë të detyrueshme në nivel nacional. Faqja zyrtare për informacion në lidhje me KOVID 19 në nivel nacional është www.koronavirus.gov.mk.

Përshkrimi i detajuar i masave dhe rekomandimeve nga Banka Botërore/OBSH dhe SHMSHP janë prezantuar në Aneksin II.

✦ **Ndikimet e mundshme në cilësinë e ajrit**

Makineritë e ndërtimit (Automjetet) dhe pajisja ndërtuese duhet të mirëmbahet në mënyrë të duhur dhe duhet të jetë në harmoni me standardet relevante të emisionit. Shpejtësia e tyre duhet të jetë e kufizuar dhe të përshtatet në mënyrë të duhur në lokacionin e ndërtimit. Gjatë gërmimit dhe transportimit të tokës të gërmuar, pritjet që të zvogëlohet apo shmanget në tërësi përmes spërkatjes në lokacionin e projektit. Është e nevojshme që të mbulohet apo spërkatet në mënyrë përkatese materiali i transportuar nga automjetet që mund të shkaktojë emitime të pluhurit dhe për të minimizuar dhe eliminuar ndikimet e dëmshme mbi popullsinë lokale reth lokacionit të ndërtimit. Për të zvogëluar shpërndarjen e pluhurit në mjedisin jetësorë, materialet e ndërtimit duhet të ruhen në zonën e lokacionit, të mbuluara në paketim origjinal. Mirëmbajtja e rregullt e automjeteve (larja e rrotave të makinerisë të ndërtimit) dhe makineritë e ndërtimit me qëllim të zvogëlimit të emisioneve dhe rritjes të ndodhtes.

✦ **Ndikimet e mundshme për shkak të zhurmës dhe vibrimit**

Si rezultat i operimit të makinerisë të ndërtimit dhe pajisjeve në lokacionin e ndërtimit gjatë aktiviteteve projektuese, do të gjenerohet niveli i rritur i zhurmës dhe veprimit. Në pajtim me legjislacionin nacional për mbrojtjen nga zhurma (GZ e RM nr. 79/07, 124/10, 47/11 dhe 163/13 dhe 146/15), lokacioni i projektit është në zonë banuese që i takon zonës të shkallës për mbrojtje kundër zhurmës (vlera e kufizuar për këtë fushë është 45dB (A) për periudhën e natës dhe 55dB(A) për ditën dhe mbrëmjen). Kontraktuesi është i detyruar që të respektojë masat e propozuara parandaluese në Planin për zbutjen e ndikimeve negative në mjedisin jetësorë si dhe kërkesat në pajtim me legjislacionin nacional për mbrojtje kundër dhunës.

✦ **Ndikimet e mundshme për shkak të llojit të ndryshëm të mbetjeve**

Pjesët kryesore të mbetjeve që do të krijohen gjatë aktiviteteve projektuese janë vlerë e vogël e mbeturinave komunale nga punëtorët (ushqim, pije, shishe plastike/xhami, etj), mbeturinat e ndërtimit nga shkatërrimi i murit ekzistues, toka e kontanimuar nga rrjedhja eventuale e vajit motorik nga përdorimi i makinerisë të ndërtimit dhe mbetjet e përziera nga heqja e dheut nga lokacioni i projektit.

Kontraktuesi është i detyruar që të respektojë kërkesat nacionale për menaxhimin e mbetjeve dhe të kryejë kategorizimin në pajtimin me Listën e mbetjeve (GZ e RM, Nr. 100/05), me qëllim që të sigurohet menaxhimi i duhur i mbetjeve në rrjedhat e gjeneruara të mbetjeve. Gjithashtu, kontraktuesi është i detyruar që të lidh një Kontratë me një person juridik të autorizuar për trajtimin e pjesëve të gjeneruara të mbetjeve. Depozitimi përfundimtar i mbetjeve komunale dhe inerte do të realizohet nga NKP "Pisha" nga Likova, dhe mbetjet do të depozitohen në deponinë komunale afër vendbanimit Nikushtak (afërsisht 6 km larg nga Matejçe). Në pajtim me dizajnin kryesor, sasia e rrjedhave të gjeneruara të mbetjeve është: gërmimi i dheut në 765 m³ dhe mbetjet nga vegjetacioni dhe degët nga pastrimi i lokacionit të ndërtimit – zona prej 360 m².

✦ **Ndikimet e mundshme në trupat ujore dhe në tokë**

Trupi më i afërt ujqor për lokacionin e projektit është Lumi Matejç (afërsisht 200m) dhe është klasifikuar si klasë II (niveli i ulët i statusit të ndotjes-mezotrofike, niveli i lartë i autopurifikimit që mund të përdoret për rritjen e peshqve, larjen, spotet ujore dhe zbavitjen). Me qëllim që të parandalohet ndotja e mundshme e ujit, Kontraktuesi duhet të respektojë dhe nënkuptojë kërkesat e dhëna në legjislacionin nacional për sektorin e ujit, me qëllim që të mbahet statusi i mirë ekologjik i Lumit Likova. Kontraktuesi duhet të ndalojë depozitimin e përkohshëm apo përfundimtar të mbetjeve afër/në shtratin e lumit të këtij pranuesi të ujit (psh hedhja e tokës, asfaltit, rrjedhjet e vajrave motorik dhe lubrifikantëve, etj).

Sipërfaqet më të afërta të trupave ujore (Liqeni i Likovës dhe Liqeni i Gllazhnjës) janë larg nga lokacioni i projektit (afërsisht 8 km në veri të Matejçes). Këto rrjedhje ofrojnë ujë të freskët për pije për Komunën e Likovës, si dhe Kumanova por nuk priten ndikime potenciale nga aktivitetet projektuese.

✦ **Ndikimet e mundshme të shumëllojshmërisë biologjike**

Në rethinën e gjërë të lokacionit të projektit ndodhen disa zona të mbrojtura: 1) Zona e rëndësishme për bimët (ZRB) "Mali i Zi i Shkupit" (që ndodhen rreth 5.5. km në perëndim nga lokacioni i projektit); 2) Zona e rëndësishme për bimët (ZRB) "Lumi Pçinja, Lumi Petroshnica Kriva Reka" (që ndodhet rreth 12.5 km në lindje nga lokacioni i projektit); dhe 2) Lokacioni Emeral "Pçinja-German" (që ndodhet rreth

30 km në juglindje nga lokacioni i projektit). Në Aneksin 1 janë prezantuar lokacionet e aktivitetit projektuese, në lidhje me lokacionin e projektit. Për shkak të distancës të gjërë ndërmjet atyre dhe zones projektuese, realizimi i projektit nuk do të shkaktojë ndonjë ndikim negativ te flora dhe fauna.

✦ **Ndikimet e mundshme mbi trashëgiminë kulturore**

Në rethinën më të gjërë të lokacionit të projektit është Manastiri i Zhegligovës (së fundi njihet si Manastiri i Matejçës) – Manastiri ortodoks maqedonas që ndodhet rreth 3 km në lindje nga lokacioni i ndërtimit në venbdanimin e Likovës. Realizimi i projektit nuk do të shkaktojë ndikime negative në trashëgiminë kulturore në f.Likovë.

5. ZBATIMI I PMMJS

Një përshkrim i shkurtër i masave të duhura për secilin medium është dhënë individualisht në Planin për masat për parandalim dhe zbutje të ndikimeve negative në mjedisin jetësorë dhe aspektet sociale të aktiviteteve projektuese, si dhe në Planin për monitorimin e zbatimit të masave.

Të gjithë masat parandaluese/zbutëse duhet të zbatohen para dhe gjatë aktiviteteve ndërtimore nga të gjithë institucionet përgjegjëse, Kontraktuesi dhe të gjithë ata që janë përfshirë në Planin për zbutje të mjedisit jetësorë. Kontraktuesi/Menaxheri i projektit dhe mbikqyrësi duhet të realizojnë monitorimin rregullisht.

Edhe pse trajnimet e SHSP janë të detyrueshme, për zbatim të lehtë dhe të sigurtë, është thelbësore që Kontraktuesi të organizojë trajnime (nëse dikush nga stafi i NJRP nevojitet, ju lutemi, ftoni ata) për punëtorët në lidhje me:

a) Punët specifike ndërtimore duhet të realizohen gjatë ndërtimit të kopshtit dhe masave të sigurisë që do të zbatohen;

b) Masat parandaluese dhe zbutëse të PMMJS të përcaktuara në këtë dokument (aspektet e mjedisit jetësorë, social dhe të punës). Ndoshta është mirë që gjatë trajnimit, Specialisti i mjedisit jetësor i NJRP të prezantojë masat e propozuara dhe si ata mund të zbatohen;

c) Masat e kujdesit të KOVID 19 për të shmangur infektim nga kovid, për të mbrojtur shëndetin e punëtorëve;

Rekomandimi është që këto trajnime të bëhen para fillimit të aktiviteteve dhe në tre muajt të organizohen dhe të mbahen trajnimet freskuese mbi temat specifike. Evidencat e trajnimit duhet të mbahen me listën e pjesëmarrësve, temat e diskutuara, etj. Evidenca për trajnimet e realizuara duhet të mbahet në zyrën e Kontraktuesit në zonën e ndërtimit si dhe në zyrën e NJRP në kuadër të MPPS. Specialisti i mjedisit jetësor duhet të shqyrtojë evidencat nga trajnimet për punëtorët para fillimit të aktiviteteve projektuese të SHSP dhe KOVID.

Për çdo punëtorë të ri që do të angazhohet gjatë aktivitetit projektues duhet të realizohet procedura e njëjtë në lidhje me trajnimet.

Personi përgjegjës për SHSP i zgjedhur nga Kontraktuesi do të ndjek zbatimin e masave SHSP nga punëtorët në lokacion çdo ditë dhe Specialisti i mjedisit jetësorë do të kryejë inspektime në paktën dy herë në muaj.

Përgjegjësia kryesore qëndron te Kontraktuesi që duhet të konsiderojë dhe të zbatojë në bazë ditore të gjithë masat e propozuara parandaluese dhe zbutëse. Mbikqyrja duhet të mbikqyr zbatimin e masave zbutëse nga nën-kontraktuesi.

Përgjegjësia kryesore e inspektimit bëhet nga nëpunësit komunal (Udhëheqësi i Projektit të Ndërtimit, Inspektori i mjedisit jetësorë dhe Inspektori komunal), që duhet të kontrollojë zbatimin e masave zbutëse dhe planin e propozuar të monitorimit.

Të punësuarit në komunë duhet të koordinojnë planin e punës të masave të propozuara me përfaqësuesit e kopshtit (drejtori, gjërat e kopshtit) dhe nën-kontraktuesi për zbatimin e lehtë të projektit dhe minimizimin e rreziqeve për mjedisin jetësorë, shëndetin dhe sigurinë.

Është e nevojshme që të kemi takime të rregullta para fillimit të aktiviteteve projektuese, si dhe gjatë aktiviteteve ndërtimore me qëllim që të diskutojmë kohën, statusin e dokumentit të përgatitur, statusin/përparimin e zbatimit të aktiviteteve projektuese me qëllim që të sigurohen praktika të mira të ndërtimit dhe sigurisë të punëtorëve dhe popullsisë të rrethinës, si dhe ndikime minimale në mjedisin jetësorë. Raportet e rregullta duhet të përgatiten në periudhë dy javore nga Menaxheri i Projektit nga Komuna e Likovës dhe të parashtrihen në NJRP nga MPPS.

Mekanizmat e ankesës

Para fillimit të aktiviteteve ndërtimore, Kontraktuesi duhet të informojë punëtorët për Formën e Ankesës dhe mundësinë për të shprehur pajtueshmërinë e tyre në lidhje me funksionimin e zonës të ndërtimit. Popullsia lokale do të njihet më këtë mundësi nga informacioni i vendosur në tabelën informuese në kuadër të komunitetit lokal, Ueb Faqes të komunës.

Gjatë realizimit të aktiviteteve projektuese, nëse popullsia nuk është e kënaqur nga realizimi i projektit, ata mund të parashtrojnë ankesat e tyre përmes Mekanizmit të ankesës, përmes përdorimit të formularit që mund të gjendet në faqen e internetit të MPPS për Projektin e ZSS <http://ssip.mtsp.gov.mk/>.

Ankuesi do të informohet për veprimin e propozuar korrektiv dhe vazhdimësinë e veprimeve korrigjuese në kuadër të 25 ditëve kalendarike pas vërtetimit të ankesës. Në situatat kur NJRP nuk ka mundësinë që të adresojë çështjen e veçantë të verifikuar përmes mekanizmit të ankesës apo nëse veprimi nuk kërkohet, do të ofojë një shpjegim/arsyetim të detajuar për atë nëse çështje nuk është adresuar. Përgjigja gjithashtu do të përmbajë një shpjegim për atë se si personi/organizata që ka ngritur ankesën mund të procedojë me ankesën në rastin kur rezultati nuk është i kënaqshëm. Në të gjithë kohët, ankuesit mund të kërkojnë mjete tjera juridike në pajtim me kornizën ligjore të Republikës të Maqedonisë së Veriut, duke përfshirë ankesën formale juridike.

6. ZBULIMI PËR PUBLIKUN

Projekt verzioni i dokumentit të kufizuar fillestar VNMJS do të jetë i disponueshëm për publikun në faqen e internetit të Komunës të Likovës (<https://komuna.elikoves.gov.mk/faqa/>) dhe faqen e internetit të NJRP të MPPS (<https://www.ssip.mk/>).

Kanali i mediave sociale i Komunës të Likovës që do të përdoret për qëllimin e ngritjes të vetëdijes për implementimin e projektit dhe rreziqet e identifikuar të MJS dhe masat e zbutjes është faqja e facebook (<https://www.facebook.com/komuna.elikoves.3>).

Gjatë 14 ditëve pas zbulimit të projektit të përgatitur të dokumentit të parë të kufizuar të VNMJS, Komuna e Likovës do të mbajë shqyrtim publik apo ngjarje përmes video konferencës me qëllim që të informojë qytetarët për nën-aktivitetet e propozuara, ndikimet e parashikuara dhe mënyrat e zbutjes të tyre.

Shpallja publike do të zhvillohet me një përshkrim të shkurtër të qëllimit të projektit, aktivitetet e projektit dhe kohëzgjatjen e aktiviteteve, ndikimet në mjedisin jetësor dhe social, masat e propozuara të VNMJS të parë të kufizuar për faqen e internetit të MPPS dhe faqen e internetit të Komunës, tabela informative në kuadër të komunitetit lokal. Shpalljet gjithashtu do të përmbajnë informacion për mundësinë për qytetarët që japin mendime/sygjerime/komente për VNMJS të përgatitur të parë të kufizuar përmes qasjes të linkut për projektin e ZSS. Personat përgjegjës nga MPPS janë Natasha T.Stojanovska dhe Znj .Ezerka Papasterevska (detaje në fq 22).

Informacione për datën dhe kohën e mbajtjes të shqyrtimit publik / video konsultimit, dhe se si palët e interesuar mund të marrin pjesë në videon për konsultim publik gjithashtu do të jetë pjesë e shpalljes.

Shpallja publike do të lançohet në stacionin lokal të radios apo TV dhe në tabelën informative në kuadër të komunitetit lokal.

Konsultimi publik për PMMJS

Duke marrë në konsideratë situatën me KOVID 19 ka mundësi për organizimin e konsultimit publik përmes videos në vend të shqyrtimit publik të zakonshëm në hapësirat e Komunës ku do të realizohet projekti. NJRP në MPPS në bashkëpunim me komunën do të përkufizojnë datën për shqyrtimin publik / video konsultimin.

Komunat do të duhet të informojnë të gjithë palët e përfshira relevante në territorin e tyre për kohën e shqyrtimit publik / video konsultimit (dhe të pyesin ata për e-mail adresën e tyre nëse ata dëshirojnë që të bashkëgjitën në takim), ashtuqë secili nga shtëpitë/zyrat e tyre mund të ndjek ngjarjen dhe të jetë pjesëmarrës aktiv. Nëse palët e përfshira nuk kanë mundësi teknike, komuna do të sigurojë një zgjidhje të duhur me qëllim që të kenë mundësi të ndjekin ngjarjen. Lista e porosive për pjesëmarrësit do të përgatitet duke marrë parasysh të gjithë palët e përfshira dhe ftesa do të dërgohet te ato me sqarim të shkurtër për:

- Qëllimin e konsultimit me publikun përmes videos;
- Linku i regjistrimit dhe udhëzimet për lidhje;
- Koha dhe data e saktë e ngjarjes;
- Disponueshmëria e projektit të parë të kufizuar të VNMJS të shpalosur për komente dhe
- Mundësia për parashtrimin e komenteve në VNMJS të parë të kufizuar të përgatitur përmes vizitës të linkut në Projektin e ZSS në faqen e internetit të MPPS.

Gjatë shqyrtimit publik / ngjarja e video konsultimit pas prezantimit të aktiviteteve kryesore të projektit dhe gjetjet kryesore nga VNMJS e parë e kufizuar, palët e përfshira që marrin pjesë mund të paraqesin komentet/pyetjet/sygjerimet e tyre dhe çfarëdo shqetësimi për projektin.

Pas mbajtjes të shqyrtimit publik / video konsultimit dhe periudhës 14 ditore për parashtrimin e komenteve, versioni përfundimtar i VNMJS të parë të kufizuar do të jetë përgatitur. Kjo do të përfshijë raportin e konsultimit publik (duke përfshirë shpalljen e ngjarjes (media apo personale)

përshkrimin e detajuar të ngjarjes, listen e pjesëmarrësve, procesverbal të takimit, komente të shprehura) dhe korrigjime të duhura në dokument në pajtim me komentet dhe vërejtjet e pranuar.

Verzioni i miratuar përfundimtar i dokumentit të parë të kufizuar të VNMJS duhet të përfshihet në Marrëveshjen e Grantit me propozuesit e nën-projektit, dhe pastaj në dokumentet përkatëse të ofertës dhe kontratat e ndërtimit.

Verzioni përfundimtar i parë i kufizuar i VNMJS do të jetë i disponueshëm në faqen e internetit të MPPS dhe në faqen e internetit të Komunës për të gjithë periudhën të zbatimit të nën projektit.

Personi i kontaktit për vetëdijen e projektit dhe konsultimin publik nga MPPS:

Znj. Natasa Tasevska-Stojanovska, Përgjegjëse për marrëdhënie me publikun për projektin

(e-mail: NTasevska-Stojanovska@mtsp.gov.mk)

Znj. Ezerka Papasterevska, Përgjegjëse për marrëdhënie me publikun për projektin

(e-mail: ezerka.papasterevska@mtsp.gov.mk)

Personi i kontaktit për ngritjen e vetëdijes dhe konsultimin publik nga Komuna e Likovës:

Z. Xhezmi Musliu , Udhëheqësi i Departamentit për revizion,

e-mail: xhezmmusliu@yahoo.com

mob.tel: +389 70 468 593

7. PLANI PËR MJEDISIN JETËSORË DHE ZBUTJEN SOCIALE

Ndikimi potencial	Shkalla e ndikimit	Masat e propozuara të zbutjes	Shpenzimi për zbatimin	Përgjegjësia
Aktiviteti i projektit: Shënim i zonës të ndërtimit për kopshtet në Komunën e Likovës				
Aspekti: SHSP (Procedurat e menaxhimit të punës) Ndikimet e mundshme negative për punëtorët, përdoruesit e objektit dhe popullsinë e përgjithshme në komunitet për shkak të: - Mos-harmonizimit me kërkesat nacionale për për shëndetin dhe sigurinë në vendet e punës - Mungesës të masave të siguruara të sigurisë në fillim të punës ndërtimore - Lëndim i kalimtarëve në afërsi të lokacionit të projektit dhe puseta dhe llogore të hapura - Mos harmonizimi me standardet dhe	Lokale/në kuadër të lokacionit të ndërtimit në f.Matejç Në afat të shkurtër gjatë ndërtimit të kopshtit Rëndësia – e madhe	Aktivitetet gjatë shënimit të lokacionit të ndërtimit: ➤ Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i Planit për shëndet dhe siguri në punë (Apo procedurat për menaxhimin e punës) para fillimit të aktiviteteve ndërtuese; ➤ Përgatitja e Planit për menaxhimin e qarkullimit para fillimit të aktiviteteve ndërtuese; ➤ Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i Planit për menaxhimin e lokacionit të ndërtimit para fillimit të aktiviteteve ndërtuese; ➤ Vendosja e informacionit për popullsinë lokale për llojin dhe kohëzgjatjen e aktiviteteve të projektit në tabelën komunale të informimit dhe faqen komunale të internetit të Komunës të Likovës: https://komunaelikoves.gov.mk/mk/; ➤ Vendosja e rrugëve të sigurta për popullsinë lokale për të patur qasje të sigurtë për të lëvizur rreth lokacionit të ndërtimit; ➤ Zbatimi i praktikës të ndërtimit të mirë: ➤ Rethimi me gardh dhe vendosja e ngjitëses dhe shenjave të paralajmërimit rreth lokacionit të ndërtimit, ➤ Vendosja e panelit për informacion në lokacionin e projektit me informacion të përgjithshëm për projektin, Kontraktuesin dhe Mbikqyrësin me informacionin e tyre të kontaktit; ➤ Ndaloni hyrjen të personat që nuk janë të punësuar në kuadër të lokacionit të projektit; ➤ Vendosja e tabelës të informimit se veshja e PPM është e detyrueshme për secilin punëtorë/vizitorë në lokacionin e ndërtimit në pikën e hyrjes; ➤ Sigurimi i informacionit përmes TV, radios dhe faqes të internetit të komunës (https://komunaelikoves.gov.mk/mk/) për aktivitetet e ndërtimit – fillimi dhe përfundimi i punëve për çdo ditë; ➤ Organizoni roje 24 orëshe për të ruajtur lokacionin e ndërtimit gjatë mbrëmjes; ➤ Vendosja e toaleteve të lëvizshme dhe pastrimi i rregullt të tyre (mbajtja e shënimeve për shërbimet e pastrimit), ➤ Vendosja e kontejnerëve për telefonat mobil të punës për administratën/udhëheqësinë e projektit, zonat për pushim të punëtorëve dhe ndrrim të veshjeve, garderobë PPM, dhe zonat për të ngrënë ushqim; ➤ Duhet të vendoset vend i parkimit të makinisë për të shmangur bllokimin e çfarëdo lëvizjeje në rrugë apo hyrjen në shëpitë/garazhat e familjes në afërsi të lokacionit;	• 150 Euro • 200 Euro • 200 EUR • 800 Euro/në muaj për ruajtjen • 700 Euro/në muaj mirëmbajtja – 100 Euro për zbrazen	• Kontraktuesi • Mbikëqyrësi • Stafi i komunës nga Komuna e Likovës (Inspektori komunal dhe Inspektori i mjedisit jetësorë) • NJRP e MPPS

Ndikimi potencial	Shkalla e ndikimit	Masat e propozuara të zbatjes	Shpenzimi për zbatimin	Përgjegjësia
procedurat e rrepta të punës me SHSP - Qasje jo-përkatese në kopsht		➤ Duhet të sigurohet që të mund të merret me vete në lokacion uji i pijshëm për punëtorët si dhe uji për qëllimet e punës; ➤ Informacioni për projektin dhe punëtorët në lokacion duhet të parashtrahet në objektin për kujdes shëndetësorë në vendbanimin Matejç (kontrata do të nënshkruhet për kujdesin shëndetësorë rast të shërbimeve të emergjencës); ➤ Koshat e mbeturinave do të vendosen në lokacion për për përzgjedhjen e mbeturinave komunale të gjeneruara nga punëtorët – xhami/plastika/letra dhe atyre të biodegradueshme); ➤ Transportimi i punëtorëve të organizohet në pajtim me masat e përkujdesit për Covid-19; ➤ Makinaria dhe pajisja e plotë e ndërtimit duhet të përdoret vetëm nga stafi me përvojë dhe trajnimi me qëllim që të zvogëlohet rreziku nga aksidentet; ➤ Zbatimi i detyrueshëm i praktikës të ndërtimit të mirë dhe zbatimi i masave të sigurisë siç janë: a) përdorimi i veshjeve dhe pajisjeve të duhura mbrojtëse nga punëtori (PPM); b) Të mbahet nivel i mirë i higjienës personale; c) Pajisjet për ndihmën e parë shëndetësore dhe shërbimet mjekësore në lokacion duhet të sigurohen gjatë punës; ➤ Është e detyrueshme që të jenë të pranishme pajisjet për fikjen e zjarrit në rast të zjarrit apo demit tjetër; ➤ Të gjithë punëtorët duhet të jenë të vetëdijshëm për rrezikun nga zjarri dhe duhet të zbatojnë masa për mbrojtjen nga zjarri dhe duhet të dijnë të përdorin aparate për fikjen e zjarrit, hidrantë dhe pajisje tjera që përdoren për fikjen e zjarrit; ➤ Nuk duhet të mbahen sasi të mëdha të lëngjeve të ndezshme në lokacion përgjatë lokacionit të projektit. ➤ Punëtorët duhet të mbajnë rregullisht të pastër lokacionin e projektit nga mbetjet dhe derdhjet e lëngjeve;		
Aktiviteti i projektit: Ndërtimi i kopshtit në Komunën e Likovës				
Aspekti: Cilësia e ajrit Ndikimi në cilësinë e ajrit si rezultat i emitimeve të shkaktuara nga pajisjet e transportit dhe makineria e ndërtimit	Lokacioni lokal/në kuadër të lokacionit të ndërtimit të vendbanimit të Likovës Afatshkurte /	➤ Automjetet dhe makineria e ndërtimit duhet të mirëmbahen mirë dhe të jetë në pajtueshmëri me standardet relevante mbi emitimet; ➤ Kufizoni shpejtësinë e pajisjeve në lokacionet ku realizohen aktivitetet e ndërtimit; ➤ Lokacioni i ndërtimit, rrugët e transportit dhe lokacionet ku përdoren materialet duhet të spërkatën me ujë në ditët e thata dhe kur ka erë; ➤ Materialet e ndërtimit duhet të mbulohen në lokacionet përkatëse për të zvogëluar shpërndarjen e pluhurit		• Kontraktuesi • Mbikëqyrësi

Ndikimi potencial	Shkalla e ndikimit	Masat e propozuara të zbatjes	Shpenzimi për zbatimin	Përgjegjësia
në kuadër të lokacionit të ndërtimit dhe rrugët lokale si rezultat i: -shkarkimeve dhe emitimeve të pluhurit nga burimet e lëvizshme (CO ₂ , NO _x , PAH, SO ₂ dhe grimcat e pezulluara (PM ₁₀ , PM _{2,5}))	Rëndësia – e madhe	➤ Mirëmbajtja e rregulltë e automjeteve (pastrimi i rrotave) dhe makinerisë të ndërtimit me qëllim që të zvogëlohet rrjedhja e vajit motorik, emitimet dhe rritja e ndotjes; ➤ Materiali i transportuar nga automjetet që emitojnë pluhur duhet të mbulohet; ➤ Në rast të emitimit të pluhurit nga funksionimi i makinerisë të ndërtimit, punëtorët duhet të përdorin maska mbrojtëse ➤ Nuk lejohet djegja e mbeturineve nga pastrimi i tokës		
<u>Aspekti: Zhurma</u> Rritja e nivelit të zhurmës dhe vibrimit si rezultat i përdorimit të makinerisë dhe pajisjes të ndërtimit në lokacionin e ndërtimit në fshatin Matejç - Niveli II i mbrojtjes nga zhurma	Lokale/afër lokacionit të ndërtimit në fshatin Matejç Afatshkurte / Rëndësia – e vogël	➤ Lokacioni për ndërtimin e kopshtit, sipas legjislacionit nacional për mbrojtje nga zhurma i takon zonës të shkallës II të mbrojtjes kundër vlerave të kufizuara të cilat shtrihen nga 45dBA për periudhën e mbrëmjes deri në 55dBA për ditën; ➤ Niveli i zhurmës nuk duhet të tejkalojë vlerat e kufizuara sipas legjislacionit ekzistues; ➤ Ndalohe kryerja e aktiviteteve ndërtimore në mbrëmje; ➤ Aktivitetet e projektit do të realizohen në periudhën prej 7:00 në mëngjes deri në 19:00 në mbrëmje; ➤ Punëtorët duhet të pajisen me pajisje mbrojtëse për veshët (kufje); ➤ Shmangja e funksionimit simultan të disa pajisjeve që emitojnë nivel të rritur të zhurmës.	• Punëtorët do të mbajnë pajisje të rregullta për mbrojtje nga zhurma	• Kontraktuesi • Mbikëqyrësi
<u>Aspekti: Mbetjet</u> Ndikimet e mundshme negative për mjedisin jetësorë dhe shëndetin e njeriut si rezultat i gjenerimit të mbetjeve në rrjedhat e ndryshme të mbetjeve -Menaxhimi jo i duhur i mbetjeve, grumbullimi, transportimi dhe	Lokale/në kuadër të lokacionit të projektit në fshatin Matejç Afatshkurte gjatë ndërtimit / Rëndësia – e madhe	➤ Identifikimi i llojeve të ndryshme të mbetjeve në lokacionin e ndërtimit (dheu respektivisht toka i/e gërmuar, mbetjet komunale, mbetjet nga paketimet, metalet, plastika etj.); ➤ Klasifikimi i mbetjeve në pajtim me listën nacionale të mbetjeve (Gazeta Zyrtare Nr.100 / 05) dhe përzgjedhja e mbetjeve në lokacion; ➤ Përgatitja e Planit për menaxhimin e mbetjeve para fillimit të aktiviteteve ndërtuese; ➤ Sasia më e madhe e mbetjeve do të klasifikohet sipas Kapitullit 17 Mbetjet "Mbetjet në ndërtim dhe shkatërrim (duke përfshirë dheun e gërmuar)" me kodin 17 05 06- dhe i gërmuar, nuk është përmendur në 17 05 05; ➤ Reciklimi dhe ri-përdorimi i disa materialeve të mbetjeve është i detyrueshëm (të mos depozitohen ata si mbetje); ➤ Transportimi dhe depozitimi përfundimtar i inerteve dhe mbetjeve jo-të rrezikshme duhet të kryhet në deponinë afër vendbanimit Nikushtak (afërsisht 6km) ;	• 500-700 Euro	• Kontraktuesi • Mbikëqyrësi • Kryetari i Komunës të Likovës dhe • NP "Higjiena Komunale", Shkup

Ndikimi potencial	Shkalla e ndikimit	Masat e propozuara të zbatueshme	Shpenzimi për zbatimin	Përgjegjësia
depozitimi përfundimtar		➤ Mbetjet e mundshme të rrezikshme (vajrat motorik, karburantët e automjeteve) duhet të ruhen në kontejnerë dytësorë përkatës me sipërfaqe të papërshkrueshme të ndërtuar me materiale që janë përkatëse për mbetjet që janë kufizuar, të mbyllura mirë dhe të kontrolluara për çfarëdo rrjedhje (kontroll i përditshëm); ➤ Kontejnerët e mbyllur duhet të mbrohen nga drita e drejtëpërdrejtë e diellit, era dhe shiu dhe nëse ka më shumë, gjithmonë të kujdesemi për distancë ndërmjet tyre për të lejuar inspektime të derdhjeve ndërmjet kontejnerëve; ➤ Kontejnerët e mbetjeve duhet të shënohen në pajtim me mbetjet e rrezikshme të ruajtura në to që thekson kodin e rrezikut të mbetjeve në pajtim me Listën nacionale të kodeve të mbetjes – në pajtim me Listën e BE-së për kodet e mbetjeve. ➤ Mbetjet e mundshme të rrezikshme (vajrat motorik, karburantët e makinave) duhet gjithashtu të grumbullohen ndaras si dhe duhet të nën-kotraktohet grumbullues dhe transportues i autorizuar për transportuar dhe për të menaxhuar përfundimisht mbetjet e rrezikshme (depozitimin final apo ripërdorimin/rikuperimin në licensimin e autorizuar të licensuar IPPC kur kjo është e mundur); ➤ Shënimet për mbetjet e rrezikshme të gjeneruara, grumbulluara dhe transportuara duhet të mbahen si një Listë e transportit me destinimin përfundimtar; ➤ Mbulimi i mbetjeve gjatë transportit për të shmangur shkarkimin e paqëllimshëm të mbetjeve në rrugë. ➤ Duhet të ndalohet djegja e mbetjeve ndërtimore.		
<u>Aspekti: Uji</u> Ndikimet e mundshme negative në ujin sipërfaqësorë të lumit Matejç afër lokacionit të projektit	Lokale/ reth 500 m në lindje nga lokacioni i projektit në fshatin Matejç Afatshkurte gjatë ndërtimit/ Rëndësia – e mesme	➤ Është e ndaluar që të kryhen depozitime të mbetjeve afër sipërfaqes të trupit ujqor (Lumi i Matejçës) që ndodhet reth 200 m nga lokacioni i projektit (nuk është rrjedhë e ngurtë apo e lëngshme e mbeturinave); ➤ Sipas Dekretit për kategorizimin e rrjedhave ujore, liqeneve, akumulimeve dhe ujërave të nëntokësorë (GZ e Republikës të Maqedonisë Nr. 18/99), ky trup ujqor është kategorizuar si klasë II. Sipas legjislacionit, Kontraktuesi është i detyruar që të parandalojë depozitimin e mbetjeve të gjeneruara (psh. Toka e kontaminuar nga rrjedhja e vajit motorik nga makineria e ndërtimit, asfalti ekzistues etj.) afër trupit ujqor gjatë kohëzgjatjes të aktiviteteve projektuese, me qëllim të parandalimit të ndotjes shtesë të ujit të lumit Matejç. ➤ Mbetjet e lëngshme duhet të ruhen në kontejnerët përkatës (lloji i mbetjeve të lëngshme dhe karakteristikat e tij duhet të përgjigjen në llojin dhe materialin e kontejnerëve) me sipërfaqe të papërshkrueshme, të vendosur larg nga drita e		• Kontraktuesi • Mbikëqyrësi • Kryetari i Komunës të Likovës dhe • NP "Higjiena Komunale, Shkup

Ndikimi potencial	Shkalla e ndikimit	Masat e propozuara të zbatjes	Shpenzimi për zbatimin	Përgjegjësia
		drejtëpërdrejtë e diellit, era dhe shiu. ➤ Gjatë gjithë kohës duhet të kemi të pranishme pajisje të lëvizshme për të parandaluar derdhjet dhe për të pastruar lokacionin dhe trajnimin për vendosjen e pajisjeve. ➤ Përveç asaj, punëtorët duhet të përdorin sipërfaqe të papërshkueshme dhe zonat tjera të bartjes të lëngjeve. ➤ Punëtorët duhet të trajnohen për transferimin e saktë dhe përdorimin e lëngjeve dhe materieve kimike dhe reagimin ndaj derdhjeve. Trajnimi duhet të jetë pjesë e trajnimit të PMMJS para fillimit të aktiviteteve projektuese.		
Aktiviteti i projektit: Faza operationale e kopshtit në f Matejç				
<u>Aspekti: Menaxhimi i mbetjeve</u> Ndikimet e mundshme negative për mjedisin jetësorë dhe shëndetin e njeriut si rezultat i gjenerimit të mbetjeve për rrjedhat e ndryshme të mbetjeve -Menaxhimi jo i duhur i mbetjeve, grumbullimit, transportimit dhe depozitimit përfundimtar	Lokale/në kopshtin e v.Likovës Afatgjatë Rëndësia – e madhe	➤ Nënshkrimi i Kontratës me Ndërmarrjen publike "Pisha", Likovë për grumbullimin, transportimin dhe depozitimin e mbetjeve komunale për në Nikushtak (reth 6km) (në pajtim me Listën e mbetjeve me kodin e mbetjeve 20); ➤ Klasifikimi i mbetjeve në pajtim me listen nacionale të mbetjeve (Gazeta zyrtare Nr.100 / 05); ➤ Ndarja e mbetjeve (letër, plastik dhe organike) nënshkrimi i Kontratës me mbajtës të licensuar për grumbullimin dhe menaxhimin me rrjedhat e ndryshme të mbetjeve	➤ Të përfshirë në buxhetin komunal për mirëmbajtje të kopshtit;	• Të punësuarit e kopshtit • Inspektori i mjedisit jetësorë
<u>Aspektet: SHSP (Procedurat për menaxhimin e punës)</u> Ndikimet potenciale negative për sigurinë e të punësuarve,	Lokale / në kopshtin e fshatit Matejç Afatgjatë	➤ Vendosja e sinjalizimit të duhur të qarkullimit në rethinën e kopshtit të ri;	• Të përfshirë në buxhetin komunal për mirëmbajtje të kopshtit	• Kryetari i Komunës të Likovës

Ndikimi potencial	Shkalla e ndikimit	Masat e propozuara të zbatjes	Shpenzimi për zbatimin	Përgjegjësia
fëmijëve dhe prindërve kur hyjnë dhe largohen nga oborri i kopshtit- Sinjalizimi jo i duhur i qarkullimit në rethinën e kopshtit dhe hyrjen në oborr	Rëndësia – e madhe			
<u>Aspekti: SHSP (Procedura e menaxhimit të punës)</u> Përgatitja e Planit menaxhimit të SHSP për kopshtin e ri	Me qëllim që të trajtojnë dhe identifikojnë rreziqet e zjarreve dhe burimeve të zjarreve, si dhe masat e nevojshme për të kufizuar zhvillimin e shpejtë të zjarrrit dhe tymit. Korniza e pritur kohore është para hapjes të kopshtit.		E përfshirë në buxhetin komunal për mirëmbajtje të kopshtit	- Drejtori i kopshtit - Kompania e autorizuar e SHSP
<u>Aspekti: SHSP (Procedurat e menaxhimit të punës)</u> Përgatitja e Planit për mirëmbajtjen e rregulltë dhe parandaluese	Për të siguruar operim të duhur të të gjithë përbërësve të infrastrukturës të kopshtit (sistemi i kanalizimit, sistemi i ujit nga stuhitë, sistemi i furnizimit me ujë, pajisjet për ngrohje, etj) dhe për të siguruar mbajtjen e shënimeve për të gjithë dokumentacionin teknik për objektin e ri të kopshtit. Korniza e pritur kohore është para hapjes të kopshtit (nevojitet të paktën periudhë 1 mujore).		Mirëmbajtja e rregulltë e kopshtit	- Drejtori i kopshtit - Roja e kopshtit

8. PLANI I MONITORIMIT TË MJEDISIT JETËSORË DHE SOCIAL

Cili <i>Parametër do të monitorohet?</i>	Ku do të monitorohet parametri?	Si do të monitorohet parametri?	Kur do të monitorohet parametri (frekuenca e menaxhimit)?	Pse do të monitorohet parametri?	Çmimi		Përgjegjësia	
					Ndërtimi	Operacionet (funksionet)	Ndërtimi i kopshtit të ri	Operimi i kopshtit të ri
Aktiviteti i projektit: Puna përgatitore/pastrimi dhe shënimi i terrenit për ndërtimin e kopshtit në fshatin Matejç								
Zbatimi i masave të sigurisë për popullsinë lokale dhe punëtorët në zonën e ndërtimit	Në zonën e ndërtimit në fshatin Matejç	Inspektimi vizuel dhe njoftimi i personave përgjegjës nga Komuna e Likovës	Pas fillimit të aktiviteteve ndërtimore (dita e hapur) me fokus në masat preliminare	Për të parandaluar rreziqet për shëndetin dhe sigurinë e fëmijëve, popullsinë lokale dhe punëtorët	I përfshirë në realizimin e buxhetit të projektit		Kontraktuesi - Ofertuesi Mbikëqyrësi i Inspektori i mjedisit jetësorë	
Koha për fillimin dhe përfundimin e punës ndërtimore	Në kuadër të lokacionit të projektit në Komunën e Likovës	Kontrolli vizuel dhe dokumentet (Shqyrtimi i orarit të kohës	Çdo ditë, gjatë realizimit të projektit	Për të shmangur mjedisin jetësorë, shëndeti dhe rreziku i sigurisë	I përfshirë në realizimin e buxhetit të projektit		Kontraktuesi-Ofertuesi /Mbikëqyrësi/St afi komunal (Inspektori komunal dhe i mjedisit jetësorë)/ Pjesët e PZSS	
Puna e përgjithshme e investitorit	Në zonën e projektit dhe rethinës të tij në vendbanimin e Likovës	Kontrolli vizuel në zonën e projektit	Para fillimit të aktiviteteve ndërtimore	Përcaktimi i kushteve të realizimit të projektit	I përfshirë në realizimin e buxhetit të projektit		Pjesët e PZSS	
Aktiviteti i projektit: Ndërtimi i kopshtit në fshatin Matejç								
Identifikimi dhe ndarja e mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme	Afër lokacionit të projektit në vendbanimin e Likovës	Inspektimet vizuale dhe njoftimet e personave përgjegjës nga	Gjatë fazës të ndërtimit	Shmangia e depozitimit të mbetjeve të rrezikshme në deponinë e zonës të projektit në Nikushtak (5 km)			Kontraktuesi - Ofertuesi Mbikqyrësi Inspektori	

VLERËSIMI I PARË I KUFIZUAR I NDIKIMIT MBI MJEDISIN JETËSORË DHE SOCIAL
Projekt i "Kategorisë B+" Ndërtimi i kopshtit të ri në Komunën e Likovës

Cili Parametër do të monitorohet?	Ku do të monitorohet parametri?	Si do të monitorohet parametri?	Kur do të monitorohet parametri (frekuenca e menaxhimit)?	Pse do të monitorohet parametri?	Çmimi		Përgjegjësia	
					Ndërtimi	Operacionet (funksionet)	Ndërtimi i kopshtit të ri	Operimi i kopshtit të ri
		Komuna e Likovës					komunal dhe I mjedisit jetësorë	
Raporti i përfundimtar vjetor për grumbullimin, transportimin dhe depozitimin e mbetjeve nga realizimi i aktiviteteve projektuese	Administrata e pushtetit lokal	Shqyrtimi i dokumentacionit – Lista e identifikimit të mbetjeve	Pas përfundimit të grumbullimit, transportimit dhe depozitimi të përkohshëm dhe përfundimtar të mbetjeve	Për të përmirësuar trajtimin e mbetjeve në nivel lokal dhe shtetëror Për të respektuar kushtet nacionale ligjore			Kryetari i Komunës të Likovës Drejtori i NKP "Pisha" nga Likova	
Emitimi i pluhurit dhe shkarkimi i gazrave nga puna e pajisjes të ndërtimit	Reth zonës të ndërtimit dhe rrugët e transportit në vendbanimin e Likovës	Monitorimi i emitimit të pluhurit dhe shkarkimit të gazrave me pajisje të kalibruara për matjen e pluhurit dhe shkarkimit të gazrave	Frekuenca e matjes do të realizohet në mënyrën e propozuar nga legjislacioni nacional	Të përcaktojë nëse niveli i emitimit në ajër është në pajtim me vlerat e propozuara të kufirit nacional			Kontraktuesi – Ofertuesi Matjet e emitimeve në ajër duhet të kryhet nga laboratorit i akredituar të angazhuar nga Kontraktuesit	
Niveli i zhurmës për pajisjen dhe makinerinë e ndërtimit	Reth zonës të ndërtimit në Komunën e Likovës	Përmes shqyrtimit të dokumentacionit teknik	Rregullisht gjatë aktiviteteve ndërtuese, përmes vizitës të zonës të projektit në pajtim me legjislacionin nacional	Të përcaktohet nëse niveli i zhurmës është sipër / nën nivelin e lejuar për matjen e zonës			Kontraktuesi – Ofertuesi Kompania e autorizuar për të kryer matjen e niveleve të zhurmës të angazhuar nga	

VLERËSIMI I PARË I KUFIZUAR I NDIKIMIT MBI MJEDISIN JETËSORË DHE SOCIAL
Projekt i "Kategorisë B+" Ndërtimi i kopshtit të ri në Komunën e Likovës

Cili Parametër do të monitorohet?	Ku do të monitorohet parametri?	Si do të monitorohet parametri?	Kur do të monitorohet parametri (frekuenca e menaxhimit)?	Pse do të monitorohet parametri?	Çmimi		Përgjegjësia	
					Ndërtimi	Operacionet (funksionet)	Ndërtimi i kopshtit të ri	Operimi i kopshtit të ri
							Kontraktuesi	
Niveli i zhurmës në mjedisin jetësorë	Në kuadër të zonës të ndërtimit	Përmes matjes të drejtëpërdrejtë të zhurmës me instrumente të përshtatshme	Pas harmonizimit apo nga kontrolli i rregullt	Për të përcaktuar nëse niveli i zhurmës është sipër / nën nivelin e lejuar të lejueshmërisë për zonën e matjes			Inspektori komunal i mjedisit jetësorë	
Puna e përgjithshme e investitorit	Në zonën e projektit dhe rethinës të tij	Kontrollet vizuale	Gjatë aktiviteteve të ndërtimit	Përcaktimi i kushteve			Pjesët e PZSS dhe specialist i SMJS	
Aktiviteti projektues: Faza operacionale e objektit të Kopshtit në fshatin Matejç								
Pija e ujit të pijshëm	Para shpërndarjes përmes sistemit të ri të furnizimit me ujë, mostra e ujit duhet të analizohet nga laboratorët e analizuar _ Instituti i shëndetit publik në Kumanovë/Lab oratorët e	Pajisja laboratorike për analizat fizike- kimike dhe mikrobiologjike të cilësisë të ujit	Para fillimit të operimit të kopshtit	Për të siguruar shpërndarjen e ujit të pijshëm të cilësisë të mirë për fëmijët që minimizojnë rreziqet e shëndetit të sëmundjeve që lidhen me ujin		I përfshirë në buxhetin e komunës për mirëmbajtje të kopshtit		Stafi komunal Nëpunësit e kopshtit Laboratorët e autorizuar / Laboratorët e akredituar

VLERËSIMI I PARË I KUFIZUAR I NDIKIMIT MBI MJEDISIN JETËSORË DHE SOCIAL
Projekt i "Kategorisë B+" Ndërtimi i kopshtit të ri në Komunën e Likovës

Cili <i>Parametër do të monitorohet?</i>	Ku do të monitorohet parametri?	Si do të monitorohet parametri?	Kur do të monitorohet parametri (frekuenca e menaxhimit)?	Pse do të monitorohet parametri?	Çmimi		Përgjegjësia	
					Ndërtimi	Operacionet (funksionet)	Ndërtimi i kopshtit të ri	Operimi i kopshtit të ri
	akredituar							
Plani për mbrojtje nga zjarri	Para fillimit të funksionimit të kopshtit	Shqyrtimi i planit	Në fillim të funksionimit të kopshtit	Për të siguruar që të gjithë masat për mbrojtje nga zjarri janë zbatuar		I përfshirë në buxhetin e komunës për mirëmbajtje të kopshtit		Stafi komunal (Inspektori komunal dhe i mjedisit jetësorë) Stafi i kopshtit
Plani për mirëmbajtjen e rregulltë dhe parandaluese të kopshtit	Para fillimit të funksionimit të kopshtit	Shqyrtimi i planit	Në fillim të funksionimit të kopshtit	Për të siguruar zbatimin e duhur të veprimeve i referohen parandalimit në kohë dhe mirëmbajtjes të rregullt, furnizimit të pjesëve rezervë, zëvendësimi i pjesëve të konsumuara që zvogëlojnë dështimet jo të planifikuara, jetëgjatësia e zgjatur e pajisjes dhe për të siguruar funksionimin e duhur dhe të sigurtë të kopshtit		I përfshirë në buxhetin e komunës për mirëmbajtjen e kopshtit		Stafi komunal (Inspektori komunal dhe i mjedisit jetësor) Stafi i kopshtit

Aneksi I Harta e zonave të ndjeshme në rethinën e gjërë dhe të ngushtë të zonës të projektit në Komunën e Likovës




Figura 7 Lokacioni i ZRB "Mali i Zi i Shkupit" në lidhje me lokacionin e projektit




Figura 8 Lokacioni i ZRZ "Lumi Pčinja-Lumi Petroshnica-Lumi Kriva Reka" në lidhje me lokacionin e projektit




Figura 9 Lokacioni i zonës Emerald "Pčinja-Geman" në lidhje me lokacionin e projektit




Figura 10 Lokacioni i Monumentit të natyrës "Orashac" në lidhje me lokacionin e projektit

Aneksi II Konsideratat për KOVID-19 në projektet e ndërtimit/punëve ndërtuese

Duke marrë parasysh situatën e re me shfaqjen e virusit KOVID 19, krahas masave standarde për sigurinë dhe mbrojtjen në punë është e rëndësishme që të realizohen masat për mbrojtje nga KOVID 19.

Pa dyshim, se Kontraktuesit do të përballen shumë me sfida në situatën e re, siç është:

- Paaftësia për të furnizuar pajisje mbrojtëse dhe dezinfektues për shkak të mungesës në treg,
- Mungesa e punës për shkak të lëvizjes të kufizuar dhe mungesës nga puna,
- Paaftësia për të ofruar material dhe pajisje për punë për shkak të bllokimeve në të gjithë segmentet e jetës në vend,
- Shqetësimet e punëtorëve për jetesën e tyre për shkak të ngarkesës të zvogëluar të punës, etj.

E para, është e nevojshme që të zbatohen masat për mbrojtje nga KOVID 19 të miratuara nga Qeveria e Republikës të Maqedonisë së Veriut me propozim të Komisionit për Sëmundje Infektuese dhe Ministrisë të Shëndetësisë. **Këto masa duhet të përditësohen në mënyrë konstante në pajtim me dispozitat e fundit të prezantuara nga Qeveria.** Kontraktuesi duhet të nominojë një person përgjegjës që do të ndjek masat e miratuara nga Qeveria dhe do të zbatojë ato në funksionimin e zonës të ndërtimit në lokacionin e projektit.

Linqet e institucioneve nacionale përgjegjëse për KOVID 19 ku Kontraktuesi mund të gjejë informacion të përditësuar dhe rekomandime:

- Qeveria e Republikës të Maqedonisë së Veriut - <https://vlada.mk/node/20488?ln=en-gb>
- Ministria e Shëndetësisë - <http://zdravstvo.gov.mk/korona-virus/>
- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale - <http://mtsp.gov.mk/covid-19.nspx>
- Ministria e Transportit dhe Komunikimeve - <http://mtc.gov.mk/Preporaki%20od%20Vlada>
- Faqja zyrtare për KOVID – 19 - <https://koronavirus.gov.mk/en>

Në nivel nacional përveç masave të prezantuara nga Qeveria për mbrojtjen nga KOVID 19, Shoqata maqedonase për siguri dhe shëndet në punë ka hartuar edhe Udhërrëfyesin parandalues për virusin Korona për siguri dhe shëndet në punë në ndërtim. Udhërrëfyesi përmban masat që Kontraktuesi nevojitet që të zbatojë me qëllim që të eliminojë mënyrat e mundshme për fitimin dhe transmetimin e KOVID 19 ndërmjet punëtorëve për zonën e ndërtimit.

Në shumë detaje në kapituj të veçantë, Udhërrëfyesi përmban:

- Ndërtimin e sfidave;
- Detyrimet për Kontraktuesin;
- Detyrimet për punëtorët;
- Përgjegjësitë për investitorët;
- Mënyrat e procedimit në rastet e dyshimit apo rastet e infektuara me KOVID 19;
- Telefonat e kontaktit të institucioneve nacionale përgjegjëse për kontaktimin e paraqitjes të ngjarjes të infektimit me KOVID 19.

Teksti i Udhërrëfyesi parandalues për virusin Korona për siguri dhe shëndet në punë në ndërtim në gjuhën maqedonase është dhënë në këtë link <http://mzzpr.org.mk/>.

Kontraktuesi gjithashtu duhet të zbatojë kërkesat e prezantuara nga Banka Botërore në lidhje me mbrojtjen e KOVID 19. Në lidhje me konsideratat e KOVID-19 në projektet e ndërtimit/punët ndërtimore të dhëna nga Banka Botërore, ata janë ndarë në disa segmente/çështjet dhe janë treguar në detaje në Tabela 3.

Tabela 3 Konsideratat për KOVID-19 në projektet e ndërtimit/punët ndërtuese të rekomanduara nga BB

Konsideratat për KOVID-19 në projektet e ndërtimit/punët ndërtuese	
Çështjet e KOVID-19	Llojet e aktiviteteve
Kontraktuesi duhet të identifikojë masat për të adresuar situatat e KOVID-19, duke marrë parasysh lokacionin, resurset ekzistuese të projektit, disponueshmërinë e furnizimeve, kapacitetin e urgjencës lokale/shërbimeve shëndetësore, shkallën deri në të cilën virusi ekziston në zonë. NJRP dhe Kontraktuesi duhet të vendosin procedura specifike për trajtimin e çështjeve të KOVID 19 në lokacionin e ndërtimit. Procedurat duhet të zbatohen, dokumentohen dhe përditësohen në pajtim me ndryshimet e fundit të prezantuara nga Qeveria dhe kushtet në lokacionin e ndërtimit.	
Vlerësimi i karakteristikave të fuqisë punëtore	- Kontraktuesi duhet të përgatisë një profil të detajuar të fuqisë punëtore të projektit, aktivitetet kryesore të punës, orari për realizimin e aktiviteteve të tilla, kohëzgjatjet e ndryshme të kontratës dhe rotacionet; - Kjo duhet të përfshijë një ndarje të punëtorëve që qëndrojnë në shtëpi (respektivisht punëtorët nga komuniteti), punëtorët që qëndrojnë në kuadër të komunitetit lokal dhe punëtorët në akomodimin në zonën e ndërtimit (respektivisht kampi i punëtorëve). Kur është e mundur, duhet gjithashtu të identifikojë punëtorët që mund të jenë më shumë në rrezik nga KOVID 19, ata me probleme themelore shëndetësore apo që mund të jenë në mënyrë tjetër në rrezik; - Konsiderata duhet të jepen për mënyrat me të cilat do të minimizohet lëvizja brenda dhe jashtë zonës të ndërtimit. Kjo mund të përfshijë zgjatjen e afateve të kontratës ekzistuese, për të shmangur kthimin e punëtorëve në shtëpi, apo rikthimin në zone të ndërtimit nga zonat e prekura.
Hyrja/dalja nga zona e ndërtimit dhe kontrollat e fillimit të punës	- Vendosja e sistemit për kontrollimin e hyrjes/daljes në lokacionin e ndërtimit, sigurimi i kufijve në lokacionin e ndërtimit dhe vendosja e hyrjes të përcaktuar/pikave dalëse (nëse ata tashmë nuk ekzistojnë). Hyrja/dalja në lokacion duhet të dokumentohet; - Trajnimi i stafit të sigurisë në sistemin (e rritur) që është vendosur për të siguruar lokacionin e ndërtimit dhe kontrollin e hyrjes dhe daljes, sjellja a kërkuar prej tyre në zbatimin e sistemit të tillë dhe konsideratat specifike të KOVID-19; - Trajnimi i stafit që do të monitorojë hyrjen në lokacionin e ndërtimit, duke iu dhënë atyre resurset që u nevojiten për të dokumentuar hyrjen e punëtorëve, kontrollimin e temperaturës dhe detajet e regjistrimit të çdo punëtori të cilit i është refuzuar hyrja; - Konfirmim se punëtorët janë me shëndet të mirë për punë para se ata të hyjnë në lokacion apo të fillojnë punën. Përderisa procedurat duhet të jenë në vend për një gjë të tillë, vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet punëtorëve me probleme themelore shëndetësore apo që në mënyrë tjetër mund të jenë në rrezik. Konsiderata duhet të bëhen edhe për demobilizimin e stafit me probleme themelore shëndetësore;

Konsideratat për KOVID-19 në projektet e ndërtimit/punët ndërtuese	
Çështjet e KOVID-19	Llojet e aktiviteteve
	- Kontrollimi dhe regjistrimi i temperaturës të punëtorëve dhe njerëzve tjerë që hyjnë në lokacionin e ndërtimit apo të kërkohet vetë-raportimi gjatë hyrjes në lokacionin e ndërtimit; - Dhënia e njoftimeve të shkurtra ditore për punëtorët para fillimit të punës, fokusimi në konsideratat specifike të KOVID-19 duke përfshirë etiketimin e kollës, higjienës të duarve dhe masave të distancimit, duke bërë demonstrimin dhe metodat pjesëmarrëse; - Gjatë njoftimeve të shkurtra ditore, përkujtimi i punëtorëve që të vetë-monitorojnë simptomat e mundshme (temperaturë, kollë, dhe simptoma tjera respiratore) dhe për t'i raportuar mbikëqyrësit të tyre apo pikave të kontaktit të KOVID-19 nëse ata kanë simptoma apo nuk ndjehen mirë; - Parandalimi i punëtorit nga zona e prekur apo që ka qënë në kontakt me personin e infektuar nga kthimi në lokacionin e ndërtimit për 14 ditë apo (nëse kjo nuk është e mundur) izolimi i punëtorit të tillë për 14 ditë; - Parandalimi i punëtorit të sëmurë që të hyjë në lokacion, duke i referuar ata në objektet lokale shëndetësore nëse është e nevojshme apo t'u kërkohet atyre që të izolojnë në shtëpi për 14 ditë
Higjiena e përgjithshme	- Vendosja e posterëve dhe shenjave reth lokacionit, me imazhe dhe tekst në gjuhët lokale (MK/ALB); - Sigurimi i objekteve për larjen e duarve me sapun, letrat higjienike me një përdorim dhe dhe koshat e mbyllur të plehrave ekzistojnë në vendet kryesore në lokacionin e ndërtimit, duke përfshirë hyrjet/daljet në zonat e ndërtimit; ku ka tualet, kantinë, apo shpërndarje të ushqimit, sigurimin e ujit të pijshëm; në akomodimin e punëtorëve; në stacionet e mbetjeve dhe në hapësirat e përbashkëta. Kur objektet për fshirjen e duarve nuk ekzistojnë apo nuk janë adekuate, duhet të bëhen arranzhime për vendosjen e tyre. Gjithashtu mund të përdoren dezinfektues për dezinfektimin e duarve me bazë alkoholi (nëse është e disponueshme, 60-95% alkohol); - Trajnimi i punëtorëve dhe stafit në lokacion e ndërtimit për shenjat dhe simptomat e KOVID-19, si ai përhapet, si të mbron veten (duke përfshirë larjen e rregullt të duarve dhe distancimin social) dhe çfarë të bëjnë nëse ata dhe njerëzit tjerë kanë simptoma; - Ndarja e një pjesë të akomodimit për vetë-karantinim paraprak si dhe izolim më formal të stafit që mund të jetë infektuar.
Pastrimi dhe depozitimi i mbetjeve	- Sigurimi i stafit të pastrimit me pajisje përkatëse të pastrimit, material dhe dezinfektues; - Trajnimit i stafit të pastrimit në procedurat e duhura të pastrimit dhe shpeshmërinë e duhur në përdorimin e lartë apo zonat me rrezik të lartë; - Kur është paraparë që pastruesit do të duhet të pastrojnë zonat që kanë qënë apo janë të dyshuara se janë kontaminuar me KOVID-19, të

Konsideratat për KOVID-19 në projektet e ndërtimit/punët ndërtuese	
Çështjet e KOVID-19	Llojet e aktiviteteve
	ofrohet për ata PPM të duhur: veshje apo përparëse, dorëza, mbtojtëse për sytë (maska, syze apo ekrane për fytyrën) dhe çizme apo këpucë të mbyllura të punës. Nëse nuk është i disponueshëm PPM i duhur, pastruesit duhet të marrin alternativat më të mira të disponueshme; - Trajnimi i pastruesvë për higjienën e duhur (duke përfshirë larjen e duarve) para, gjatë dhe pas kryerjes të aktiviteteve të pastrimit; si të përdorin në mënyrë të sigurtë PPM (kur nevojitet); në kontrollimin e mbetjeve (duke përfshirë për PPM të përdorur dhe material pastrimi); - Çfarëdo mbetje mjekësore që është prodhuar gjatë kujdesit të mjekëve të sëmurë duhet të mblidhet në mënyrë të sigurtë në kontejnerët e caktuar dhe të trajtohet dhe depozitohet sipas kërkesave relevante (psh., nacionale - http://www.moep.gov.mk/?nastani=%d0%bf%d1%80%d0%b5%d0%bf%d0%be%d1%80%d0%b0%d0%ba%d0%b8-%d0%b7%d0%b0-%d1%83%d0%bf%d1%80%d0%b0%d0%b2%d1%83%d0%b2%d0%b0%d1%9a%d0%b5-%d1%81%d0%be-%d0%be%d1%82%d0%bf%d0%b0%d0%b4-%d0%b7%d0%b0-%d0%b3%d1%80, OBSH). Nëse djegja në hapësirë të hapur dhe djegja e mbetjeve mjekësore është e nevojshme, kjo duhet të jetë për kohëzgjatje sa më të kufizuar. Mbetjet duhet të zvogëlohen dhe ndahen, ashtuqë vetëm sasia më e vogël e mbetjeve do të digjet.
Përshtatja e praktikave të punës	- Rritja e madhësisë të ekupeve të punës; - Kufizimi i numrit të punëtorëve në lokacionin e ndërtimit gjatë gjithë kohës; - Ndrrimi në rotacion pune prej 24 orësh; - Përshtatja apo ridizajnimi i proceseve të punës për aktivitetet specifike të punës dhe detyrat për të mundur distancimin social, dhe trajnimin e punëtorëve në këto procese; - Vazhdimi me trajnimet e zakonshme të sigurisë, duke shtuar konsideratat specifike për KOVID-19. Trajnimet duhet të përfshijnë përdorimin e duhur të PPM normale. Ndërsa që nga data e këtij shënimi, këshilla e përgjithshme është që punëtorët e ndërtimit nuk kërkojnë PPM specifike për KOVID-19, kjo duhet të mbahet nën shqyrtim; - Arranzhimi (ku është e mundur) për marrjen e pushimeve në zonat e jashtme në kuadër të lokacionit të ndërtimit; - Të konsiderohet ndryshimi i dizajnit të kantinës dhe kohët e ushqimeve të jenë në faza për të lejuar distancimin social dhe qasjen në faza për dhe/ose qasja e përkohshme e kufizuar për hyrjen në objektet për aktivitete të lira që mund të ekzistojnë në lokacion, duke përfshirë

Konsideratat për KOVID-19 në projektet e ndërtimit/punët ndërtuese	
Çështjet e KOVID-19	Llojet e aktiviteteve
	gjimnastikën; Në një pikë të caktuar, mund të jetë e nevojshme që të shqyrtohet orari i përgjithshëm i projektit, për të vlerësuar shkallën në të cilën duhet të përshtatet (apo puna të ndalet në tërësi) për të pasqyruar praktikën e kujdeshme të punës, ekspozimin potencial të punëtorëve dhe komunitetit dhe disponueshmëria e furnizimeve, duke marrë parasysh këshillën dhe udhëzimet e Qeverisë.
Shërbimet mjekësore të projektit	- Zgjerimi i infrastrukturës mjekësore dhe përgatitja e zonave ku mund të izolojnë pacientët. Objektet për izolim duhet të jenë vendosur larg nga akomodimi i punëtorëve dhe aktiviteteve vijuese të punës. Kur është e mundur, punëtorët duhet të kenë një dhomë të vetme me ventilim të mirë (dritare dhe dyer të hapura). Kur kjo nuk është e mundur, objektet e izolimit duhet të lejojnë të paktën ndërmjet punëtorëve në dhomën e njëjtë, ndarjen e punëtorëve me perde, nëse është e mundur. Punëtorët e sëmurë duhet të kufizojnë lëvizjet e tyre, të shmangin zonat dhe objektet e përbashkëta dhe të mos lejohen vizitorët derisa ata të mos kenë simptoma për 14 ditë. Nëse ata duhet që të përdorin zona dhe objekte të përbashkëta (psh. Kuzhina apo kantina) ata duhet të bëjnë një gjë të tillë vetëm kur punëtorët që nuk janë të infektuar nuk janë të pranishëm dhe zonat/pajisjet duhet të jenë të pastra para dhe pas përdorimit të tyre. - Trajnimi i stafit mjekësorë, që duhet të përfshijë këshillat aktuale të OBSH për KOVID-19 dhe rekomandimet për specifikat e KOVID-19. Kur dyshohet për infektim me KOVID-19, ofruesit mjekësorë në lokacion duhet të ndjekin udhëzimet e përkoshme të OBSH për parandalimin e infektimit dhe kontrolli gjatë kujdesit shëndetësorë kur dyshohet për infeksion të ri me koronavirus (nCoV); - Vlerësimi i rezervave aktuale të pajisjeve, furnizimeve dhe ilaçeve në lokacion, dhe marrja e rezervave shtesë në lokacion, kur kërkohet dhe është e mundur. Kjo mund të përfshijë PPM mjekësore, siç janë veshjet, përparëset, maskat mjekësore, dorëzat, mbrojtjen e syve, etj..; - Shqyrtimi i metodave ekzistuese për trajtimin e mbetjes mjekësore, duke përfshirë sistemet për ruajtje dhe depozitim.
Shërbimet mjekësore lokale dhe shërbimet tjera	- Kryerja e diskutimeve preliminare me objektet specifike mjekësore, për t'u pajtuar se çfarë duhet të bëhet në rast se punëtorët e sëmurë duhet të referohen; - Marrja e informacionit për resurset dhe kapacitetin e shërbimeve mjekësore lokale (psh numri i shtretërve, disponueshmëria e stafit të trajnuar dhe furnizimet themelore); - Sqarimi i mënyrës në të cilën një punëtorë i sëmurë do të transportohet në objektin mjekësorë, dhe kontrollimi i disponueshmërisë të transportimit të tillë; - Marrëveshje me shërbimet lokale mjekësore/objektet specifike mjekësore për shërbimet që duhet të ofrohen, procedurat për marrjen e

Konsideratat për KOVID-19 në projektet e ndërtimit/punët ndërtuese	
Çështjet e KOVID-19	Llojet e aktiviteteve
	pacientëve dhe (kur është relevante) shpenzimet apo pagesat që mund të përfshihen; Duhet të përgatitet procedura ashtuqë drejtuesit e projektit e dijnë se çfarë të bëjnë në fatkeqësi në të cilën punëtori i sëmurë me KOVID-19 vdes. Përdorja e procedurave normale të projektit do të vazhdojnë të zbatohen, KOVID-19 mund të paraqesë çështje tjera për shkak të natyrës të infektimit të sëmundjes. Projekti duhet të lidhet me institucionet tjera relevante për të koordinuar se çfarë duhet të bëhet, duke përfshirë raportimin tjetër të kërkesave tjera sipas ligjit nacional;
Instancat apo përhapja e virusit	- Nëse një punëtorë ka simptoma të KOVID-19 (psh. Temperaturë, kollë të thatë, lodhje) punëtori duhet që të largohet menjëherë nga aktivitetet e punës dhe të izolohet në lokacionin e ndërtimit; - Punëtori duhet të transportohet në objektet lokale shëndetësore që të testohet (nëse testimi është i disponueshëm dhe i lejuar sipas legjislacionit nacional); - Nëse testi është pozitiv për KOVID-19 apo nuk ka test të disponueshëm, punëtori duhet të vazhdojë në izolim. Kjo do të jetë qoftë në lokacionin e punës ose në shtëpi. Nëse është në shtëpi, punëtori duhet të transportohet në shëpinë e tij, me transportim të ofruar nga projekti; - Procedurat zgjeruese të pastrimit me dezinfektues me përmbajtje të lartë të alkoholit duhet të ndërmerren në zonën ku punëtori është i pranishëm, para se të ndërmerret ndonjë punë tjetër në zonë. Mjetet e përdorura nga punëtori duhet të pastrohen me përdorim të dezinfektuesve me PPM; - Bashkëpunëtorët (respektivisht punëtorët me të cilët punëtori ishte në kontakt të ngushtë) duhet që të ndalin punën, dhe të kërkohet që të jenë në karantinë për 14 ditë, edhe nëse nuk kanë simptoma; - Familja dhe kontaktet tjera të afërta të punëtorit duhet që të karantinojnë veten për 14 ditë, nëse ata nuk kanë simptoma; - Nëse një rast me KOVID-19 është konfirmuar te një punëtor në lokacion, vizitorët duhet të kufiohen nga hyrja në lokacion dhe grupet e punëtorëve duhet të jenë të izoluar nga njëri tjetri sa më shumë që është e mundur; - Nëse punëtorët jetojnë në shtëpi dhe kanë punëtorë që ka një rast të konfirmuar apo të dyshuar me KOVID-19, punëtori duhet të karantinojë veten dhe të mos lejohet në lokacionin e projektit për 14 ditë, edhe nëse ata nuk kanë simptoma; - Punëtorët duhet të vazhdojnë që të paguhet në periudha të sëmundjes, izolimit apo karantinës, apo nëse kërkohet që ata të ndalin punën, në pajtim me ligjet nacionale;

Konsideratat për KOVID-19 në projektet e ndërtimit/punët ndërtuese	
Çështjet e KOVID-19	Llojet e aktiviteteve
	Kujdesi shëndetësorë (qoftë në lokacion apo në spitalet apo klinikat lokale) të kërkuara nga punëtori duhet të paguhet nga punëdhënësi.
Vazhdimësia e furnizimeve dhe aktiviteteve të projektit	- Identifikoni individët reserve respektivisht zëvendësimet, në rast se sëmuren personat kryesorë në kuadër të ekipit drejtues të projektit (NJRP, Inxhinieri mbikqyrës, Kontraktuesi, nën-kontraktuesi), dhe të komunikohet se kush janë këto ashtuqë njerëzit janë të vetëdijshëm për arranzhimet e vendosura; - Dokumentoni procedurat, ashtuqë njerëzit e dijnë se çfarë janë ato, dhe nuk mbështeten në njohurinë e një personi; - Kuptoni zinxhirin e furnizimit për furnizimet e nevojshme të energjisë, ujit, ushqimit, furnizimeve mjekësore dhe pajisjet për pastrim, konsideroni se si mund të ndikohet, dhe çfarë alternativa ka në dispozicion. Është i rëndësishëm rishikimi i hershëm pro-aktiv i zinxhirëve të furnizimit ndërkombëtarë, rajonal dhe nacional, sidomos për ato furnizime që janë kritike për projektin (psh karburanti, ushqimi, ilaçet, furnizimet për pastrim dhe furnizimet tjera themelore). Planifikimi për 1-2 ndërprerje të të mirave (mallrave) kritik mund të jetë i nevojshëm për projektet në shumë zona në distancë; - Përgatitni porositë për/furnizoni furnizimet kritike. Nëse nuk është e disponueshme, merrni në konsideratë alternativat (ku është e mundur); - Konsideroni sigurinë ekzistuese në arranzhimet, dhe nëse kjo do të jetë adekuate në rast të ndërprerjes të funksionimit normal të projektit; - Konsideroni se në cilën pikë mund të bëhet e nevojshme për projektin që të zvogëlojnë në mënyrë të konsideruar aktiviteteve apo që të ndalojnë tërësisht së punuari, dhe çfarë duhet të bëhet për tu përgatitur për këtë, dhe për të rifilluar punën kur bëhet e mundur apo e lejueshme.
Plani për kontingjencat e shpërthimit	Plani për kontingjencat duhet të hartohet për çdo lokacion dhe duhet të caktohen procedurat që do të zbatohen në rast se KOVID-19 arrijnë në lokacion. Plani për kontingjencat duhet të hartohet në konsultim me objektet nacionale dhe lokale të kujdesit shëndetësorë dhe ndjekin udhëzimin shtetëror për përgjigje ndaj KOVID-19, për të siguruar se janë vendosur arranzhimet për frenimin, kujdesin dhe trajtimin efektiv të punëtorëve të cilët kanë kontraktuar KOVID-19. Plani për kontingjencat duhet gjithashtu të konsiderojë përgjigjen nëse një numër i konsideruar i forcës punëtore sëmuret, kur ka gjasa që qasja në dhe nga lokacioni do të kufizohet për të shmangur përhapjen. Duhet të hartohen kontigjencat dhe t'i komunikohen fuqisë punëtore për: - Izolimin dhe procedurat e testimit për punëtorët (dhe ata me të cilët kanë qënë në kontakt) që shfaqin simptoma; - Kujdesi dhe trajtimi për punëtorët, duke përfshirë edhe ku dhe si do të ofrohet;

Konsideratat për KOVID-19 në projektet e ndërtimit/punët ndërtuese	
Çështjet e KOVID-19	Llojet e aktiviteteve
	- Marrja e furnizimeve përkatëse të ujit, ushqimit, furnizimeve mjekësore dhe pajisjet e pastrimit në rast të shpërthimit në lokacion, sidomos duhet që qasja në lokacion të jetë e kufizuara apo lëvizja e furnizimeve të jetë e kufizuar. Në mënyrë specifike, plani duhet të parashoh se çfarë do të bëhet nëse dikush do të sëmuret me KOVID-19 në lokacion e punës. Planin duhet: - Të vendosë arranzhimet për vendosjen e personit në dhomë apo zonë ku ata janë të izoluar nga të tjerët në vendin e punës, kufizimi i numrit të personave të cilët kanë kontakt me personin dhe kontaktimi i institucioneve lokale shëndetësore; - Konsiderojë se si të identifikoni personat që mund të jenë në rrezik (psh për shkak të kushteve para ekzistuese siç janë diabeti, sëmundja e zemrës dhe mushkërive, apo si rezultat i moshës të vjetër) dhe të mbështesin ata, pa përfshirë stigmën apo diskriminimin në vendin tuaj të punës; dhe - Konsiderojë kontingjencat dhe arranzhimet e vazhdimësisë afariste nëse ka një shpërthim në komunitetin fqinj. Planin i kontingjencës duhet të konsiderojë arranzhimet e ruajtjes dhe depozitimit të mbetjeve mjekësore, që mund të rrisin vëllimin dhe që mund të mbesin infektuese për disa ditë (në varësi nga materiali). Mbështetja që mund t'i nevojitet stafit mjekësorë në lokacion, si dhe arranzhimet për transportin (pa rrezikun për infektimin e kryqëzuar) të punëtorëve të sëmurë në objektet për kujdes intensiv apo nën kujdes të objekteve nacionale të kujdesit shëndetësorë duhet të diskutohet dhe të dakordohet Planin i kontingjencës duhet gjithashtu të konsiderojë se si të mbahen punëtorët dhe komuniteti të sigurtë në lokacion nëse lokacioni mbyllet në pajtim me politikat nacionale apo korporative, nëse duhet që puna të suspendohet apo nëse sëmundja do të prek numër të konsideruar të fuqisë punëtore. Është e rëndësishme që të shqyrtohen masat e sigurisë të lokacionit të punës nga një specialist i sigurisë dhe zbatohen para se të ndalen zonat e punës.
Trajnimi dhe komunikimi me punëtorët	- Informimi i rregullt dhe angazhimi i punëtorëve (psh. Përmes trajnimeve, diskutimeve të hapura, pakot e mjeteve) për të theksuar se çfarë drejtuesit po bëjnë për të trajtuar rreziqet e KOVID-19. Punëtorëve duhet t'ju jepet mundësia për të shtruar pyetje, të paraqesin shqetësimet e tyre dhe të bëjnë sygjerime; - Trajnimi duhet të adresojë çështjen e diskriminimit apo paragjykit nëse një punëtorë sëmurë dhe të ofrojë një mirëkuptim për trajektoren e virusit, kur punëtorët kthehen në shtëpi; - Trajnimi duhet të mbulojë të gjithë çështjet që zakonisht do të kërkohen në lokacionin e punës, duke përfshirë përdorimin e procedurave të sigurisë, përdorimin e PPM të ndërtimit, çështjet e shëndetit dhe sigurisë në punë, dhe kodi i sjelljes, duke marrë parasysh se praktikatat e punës mund të jenë përshtatur;

Konsideratat për KOVID-19 në projektet e ndërtimit/punët ndërtuese	
Çështjet e KOVID-19	Llojet e aktiviteteve
	Komunikimi duhet të jetë i qartë, bazuar në fakte dhe i dizajnuar që të kuptohet lehtësisht nga punëtorët, për shembull përmes shfaqjes të posterëve për larjen e duarve dhe distancimin social, dhe çfarë të bëhet nëse një punëtorë shfaq simptoma.
Komunikimi dhe kontakti me komunitetin	- Komunikimi duhet të jetë i qartë, i rregulltë, i bazuar në fakt dhe i dizajnuar që të kuptohet lehtësisht nga anëtarët e komunitetit; - Komunikimi duhet të përdorë mjetet e disponueshme. Në shumicën e rasteve, takimet me prani fizike me komunitetin dhe përfaqësuesit e komunitetit nuk do të jetë i mundur. Duhet të përdoren forma tjerra të komunikimit, platformat elektronike, mediat sociale, posterët, pamfletët, radio, porositë tekstuale, takimet virtual. Mjetet e përdorura duhet të marrin parasysh aftësinë e anëtarëve të ndryshëm të komunitetit për qasje në to, për të siguruar që komunikimi i arrin këto grupe; - Komuniteti duhet të jetë i vetëdijshëm për procedurat e vendosura në lokacion për të adresuar çështjet që lidhen me KOVID-19. Kjo duhet të përfshijë të gjithë msat që zbatohen për të kufizuar apo ndaluar kontaktet ndërmjet punëtorëve dhe komunitetit. Komuniteti duhet të jetë i vetëdijshëm për procedurat për hyrje/dalje në lokacion, trajnimi i dhënë për punëtorët dhe procedurat që do të vijnë nga projekti nëse sëmuret një punëtorë.
Raportimi i Kovid-19	Kontraktuesi duhet të raportojë shpërthimin e incidentit "serioz". Kontraktuesi duhet të mbajë të informuar Huamarrësin për çfarëdo shqetësimi apo problem të lidhur me ofrimin e kujdesit për punëtorët e infektuar në lokacionin e projektit, sidomos nëse shkalla e infektimit arrin 50% të fuqisë punëtore.